

UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE

FAKULTETI JURIDIK

DEPARTAMENTI I SË DREJTËS CIVILE



PUNIM DIPLOME-MASTER

**KOMPENZIMI I DËMIT MATERIAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
SË VERIUT, GJËGJSISHTË NË GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP, NGA
VITI 2015 E KËNDEJ.**

Kandidati:

Lirjeta Ramizi

Mentori:

Prof.dr.Adnan Jashari

Tetovë, 2020

HYRJE

Një punim shkencor, ka një strukturë dhe një qëllim të caktuar dhe përmes të cilit studenti edhe simbolikisht i përfundon studimet në një nivel të caktuar, në rastin tim, studimet pasdiplomike. Jam përpjekur që në këtë punim ti përmbahem disa rregullave formale dhe strukturore, e që bashkë me një përmbajtjeje të mirë, e bëjnë punimin më të plotë.

Vet rrethi që na rrethon, kushtet e jetës si dhe vetë jeta na sjellin në situata të ndryshme, ballafaqohemi me situata kur shpesh ndeshemi më veprime të ndryshme, ku si rezultat i tyre vjen deri te shkaktimi i ndonjë dëmi.

Në jetën e përditshme, çdokush nga ne së paku një herë dikujt i ka bërë dëm. Në këtë situatë ne si dëmtues , në kuptimin juridiko civil, e kemi për obligim që të kompënzojmë të njejtën. Por ne mund të jemi edhe si palë e dëmtuar, atëherë ne e kemi të drejtën që dëmi të na kompënzohet. Në sistemin juridiko civil të vendit tonë kjo gjë është e rregulluar me Ligjin për mardhëniet detyrimorë, ku janë paraparë lloje të ndryshme të dëmeve, por që theks të vecant, kanë dhe më së shumti i hasim në praktik e ato janë dëmi material dhe jomaterial. Edhe pse dëmi si i tillë është i rregulluar në të drejtën civile, shkaktimi i demit në disa raste kompënzohet edhe në aspektin juridiko penal në bazë të rregullave penale.

Në fillim të punimit jamë munduar të sjellë disa koncepte bazë në lidhje me dëmin, nocionin, llojet e tij. Duke patur parasysh që e drejta e detyrimeve është degë e veçantë e së drejtës dhe bënë pjesë në grupin e lëndëve civile, ajo përfshinë normat juridike të cilat rregullojnë mardhëniet e detyrimeve si mardhëniet pasurore midis personave.

Dëmi është burim nga i cili krijohen detyrimet. Me vetë shkaktimin e dëmit qoftë material apo jomaterial paraqitet nevoja e shpërblimit të dëmit të shkaktuar, apo kompënzimin e demit. Dëmi matërial paraqitet si zvoglim i pasurisë së dikujt dhe si ndalim i zmadhimit të sajë(si fitim i humbur). Prandaj, për të ekzistuar dëmi qoftë material apo jomaterial, duhet të ekziston edhe subjekti i cili e ka shkaktuar, apo dëmtuesi dhe i dëmtuari. Ligji mbi mardhëniet e detyrimeve i Republikës së Maqedonisë në nenin 147 parasheh që ai që me fajë do ti shkaktoj dëm tjetrit është i obligueshëm që ta kompënzojë dëmin e shkaktuar. Nga kjo konkludojm se për të ekzistuar dëmi matërial apo jomaterial përpos subjekteve duhet të ekzistoj edhe fajti. Pikërishtë në këtë aspekt jamë munduar të paraqesë punimin duke e shqyrtuar anën praktike të vendimeve që kanë të bëjnë më dëmin matërijal kur ekziston fajti, në bazë të shembujve nga praktika

gjygjësore e Gjykatës themelorë Shkupi 1 Shkup, ku mund të shohim se si ligjet janë praktikuar apo zbatuar na praktik prej vitit 2015 e këndeje. Këto shembuj janë përdorur nga arsyeja e vetme se përdorimi i shembujve është një nga mënyrat më frytëdhënëse për të ilustruar e shpjeguar ide.

Parimi i ndalimit të shkaktimit të dëmit është parim themelor i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës Veriore të Maqedonisë. Në nenin 9 është paraparë që secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mundë ti shkaktojë dëm tjetrit. Kjo dispozitë juridike e ligjit është me karakter urdhërues. Ky ndalim i shkaktimit të dëmit u drejtohet të gjithë personave-pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve - personave fizikë dhe atyre juridikë. Neni 9 i këtij Ligji kërkon nga pjesëmarrësit që të mos ndërmarrin veprime të kundërligjshme, që kanë për pasojë shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë deliktore civile, (për këtë çështje do të ndalemi më shumë të shqyrtimi i neneve lidhur me përgjegjësitë deliktore civile). Cenimi i këtij parimi ka për rrjedhojë krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve, nga e cila për njërin palë rrjedh e drejta për shpërblimin e një dëmi të tillë, ndërsa për palën tjetër lind detyrimi që dëmin e tij ta shpërblejë.

Me ndihmën e statistikave do të arrijmë të ajo, sa qytetarët, kanë njohuri për të drejtat dhe detyrimet e tyre që kanë të bëjnë pikërisht me dëmin material, si dhe këto të drejtat kur kanë të drejtë ti realizojnë si dhe shumë pyetje të tjera lidhur me dëmin e shkaktuar material të cilat jam munduar ti paraqesë më poshtë.

Ky punim ka për qëllim që hulumtimi im të shërbejë për informim të qytetarëve, të cdo lexuesi, studenti, në lidhje me dëmin material si dhe për të drejtat e tyre lidhur me shkaktimin e dëmit material, çka parasheh ligji për parandalimin e këtyre dëmeve.

Shpresojë që i jam përmbajtur disa rregullave themelore dhe kam bërë këtë punim aq të thjeshtë, saqë edhe dikush që nuk studion këtë fushë të jetë në gjendje ta kuptojë thelbinë dhe përmbajtjen e saj. Nëse këtë e kam arritur, jam e kënaqur dhe shpresojë që ai që e lexon do të ndihet njejtë.

PARASHTRIMI I PROBLEMIT

Kur flasim për kompenzimin e dëmit material duhet cekur se çdo legjislacion për vete e rregullon në mënyra të ndryshme çështjen e kompenzimit të dëmit. Ligji i procedurës civile si kushte të përgjithshme për shkaktimin e dëmit ka paraparë: dëmi të jetë i shkaktuar në mënyrë të kundërligjshme, ekzistimi i fajit te personiqë e shkakton dëmin, të ekzistoj lidhja e kundërligjshme në mes të veprimit dhe dëmit. Ligji për mardhënie detyrimore dhe Ligji për procedure penale janë baza e këtij punimi të masterit. Dëmi shkaktohet çdoherë kur dëmtuesi i shkakton dëm personit tjetër apo të dëmtuarit. Nëpërmjet praktikës gjyqësore të Gjykatës Penale Shkup, shohim se si ligji zbatohet në praktikë, respektivisht cilat janë rastet kur gjykata krahasë vendosjes së fajësis të të akuzuarit vendos edhe për kompenzimin e dëmit material në bazë të dispozitave të parapara ligjore. Nga ana tjetër me ndihmën e hulumtimit empirik të realizuar nëpërmjet anketës, vimë deri te të dhënat se sa qytetarët e Republikës së Maqedonisë Veriore kanë njohuri për të drejtat e tyre në rast të realizimit të dëmit material.

QËLLIMI I TEMËS

Edhe pse çështja e kompenzimit të dëmit është kryesisht çështje e procedures civile, kompenzimi i dëmit material realizohet edhe në procedure penale me rastin e vendosjes së çështjes penale vendoset edhe kompenzimin e dëmit material apo ndryshe njihet edhe si procedura e bashkangjities- ad hezione. Rëndësia e kësaj fushe është mjaft e gjërë, mirpo çështja e kompenzimit të dëmit material shumë pak është trajtuar nga autorë të ndryshëm. Prandaj duke u nisur nga kjo, qëllimi i studimit të kësaj teme është që të studijohen dhe trajtohen dispozitat juridike që i referohen kësaj fushe. Qëllimi i punimit është edhe arsyeja që të fitohen njohuri lidhur me kompenzimit e dëmit material, realizimin e tij në procedurën e vendosjes së çështjes penale dhe civile. Periudha prej vitit 2015 e këndej paraqet periudhën kur në masë të gjërë ka ngritje spontane të dëmit nga veprat penale. Nga të gjitha dëmet e shaktuara nga veprat penale dominojnë veprat e vjedhjes, vjedhje me dhunë, vjedhje e rrymës elektrike veprat e shkaktuara në komunikacion dhe dhuna në familje, mashtrimi, ku si rezultat i veprimeve të tilla prashtrohet kërkesa pasuroro juridike për kompenzimin e dëmit material.

METODOLOGJIA

Metodologjia e punës është bazuar si në vijim:

1. Analiza e nocioneve dhe definicioneve
2. Analiza e gjendjes dhe interpretimi korrekt, objektiv i cili refuzon idealizmin por përfshinë kauzalitetin në argumentim.
3. Metoda krahasuese-krahasimi i ligjeve. Pavarësisht se studimi nuk realizohet në kuadër të të së drejtës së krahasuar.
4. Metoda e analizës së praktikës gjyqësore duke patur parasysh faktin se praktika gjyqësore në vendin tonë në fushën e kompenzimit të dëmit material është akoma shumë e varfur.
5. Metoda emperike-hulumtimi emperik.

PËRMBAJTA

HYRJE.....	2
PARASHTRIMI I PROBLEMIT.....	4

KAPITULLI I PARË

NË PËRGJITHSI PËR DËMIN, LLOJET E DËMIT, PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN, FAJI DHE PADIA PËR KOMPENZIMIN E DËMIT.....	8
---	----------

1.DËMI DHE DEFINIMI.....	9
1. 1.Definicioni i dëmit.....	9
1.2. Palët në mardhënien detyrimore.....	10
2. LLOJET E DËMIT.....	12
2.1. Dëmi material.....	12
2.2. Dëmi jomaterial.....	15
3. PËRGJEGJËSIA DHE LLOJET E PËRGJEGJËSISË SË DËMIT.....	16
3.1. Përgjegjësia subjektive.....	16
3.2. Përgjegjësia objektive.....	16
3.3. Përgjegjësia për të tjerët.....	16
4.. FAJI DHE SHKAKTIMI I DËMIT.....	17
4.1. Kuptimi i fajit.....	17
4.2. Shkaktimi i dëmit.....	17
4.3. Mënyrat e shkaktimit të dëmit.....	18
4.4. Aftësia deliktore.....	18
4.5. Pasojat nga shkaktimi i dëmit.....	20

KAPITULLI I DYTË

PADIA PËR KOMPENZIMIN E DËMIT

1. Kuptimi.....	21
2. Paraqitja e padisë.....	21
3. Legjitimimi aktiv dhe pasiv.....	22
4. Afatet për paraqitjen e padisë.....	24

KAPITULLI I TRETË

KOMPENZIMI I DËMIT MATERIAL NË REPUBIKËN E MAQEDONISË VERIORE GJEGJËSISHT NË GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP NGA VITI 2015 E KËNDEJ.....	26
KAPITULLI I PARË.....	27
1. KOMPENZIMI I DËMIT MATERIAL NË GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP.....	27
1.1. Bazat e kompenzimit të dëmit material në Gjykatën Shkupi 1 Shkup.....	27
1.2. Mënyrat e kompenzimit të dëmit material në Republikën e Maqedonisë Veriore.....	29

KAPITULLI I KATËRT

1. TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME KOMPENYIMIN E DËMIT NGA PRAKTIKA GJYGJËSORE NË GJYKATËN THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP NGA VITI 2015 E KËNDEJ.....	32
1.1. Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndyshme juridike penale prej vitit 2015-2018.....	32
2. RASTET NGA PRAKTIKA GJYQËSORE KU ËSHTË VENDOSUR PËR KOMPENZIMIN E DËMIT MATERIAL NË GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP NGA VITI 2015 E KËNDEJ.....	36
2.1. Rasti i pare –Aktgjykimi i shpalluar në vitin 2016.....	36
2.1.1. Analiza e rastit të parë nga praktika gjyqësore.....	41
2.2. Rasti i dytë- Aktgjykim i shpallur në vitin 2017.....	44
2.2.1. Analiza e rastit të dytë nga praktika gjyqësore.....	48

2.3. Rasti i tretë –Aktgjykimi i shpallur në vitin 2018.....	50
2.3.1. Analiza e rastit të tretë nga praktika gjyqësore.....	57
2.4. Rasti i katërt- Aktgjykim i shpallur në vitin 2019.....	59
2.4.1. Analiza e rastit të katërt nga praktika gjyqësore.....	65
3. HULUMTIMI EMPERIK.....	67
PËRFUNDIMI.....	74
BIBLIOGRAFIJA.....	77
ANEX : PYETËSORI.....	79

PJESA E PARË
NË PËRGJITHSI PËR DËMIN, LLOJET E DËMIT,
PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN, FAJI DHE PADIA PËR
KOMPENZIMIN E DËMIT

KAPITULLI I PARË

NË PËRGJITHSI PËR DËMIN, LLOJET E DËMIT, PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN, FAJI DHE PADIA PËR KOMPENZIMIN E DËMIT

1.DEMI DHE DEFINIMI

1.1 Definicioni i dëmit

Shikuar nga aspekti historik fillet e mardhënieve detyrimore lidhur me shkaktimin e dëmit kanë ekzistuar qysh më herët, e shikuar nga aspekti historikë janë zhvilluar në etapa të ndryshme duke pësuar ndryshime. Shikuar historikisht dëmi për të gjitha deliktët ka qenë i njejtë. Bëhët fjalë për përgjegjësin e njohur në at kohë, apo më mirë thënë për dëmin e njohur si talion(nga fjala latine-i tillë), ku ne legjislacionin romak talioni është bazuar në parimin sy për sy -dhëmbë për dhëmbë.¹

Termi “dëm” origjinën e ka nga gjuha latine, ku përdoreshin shprehjet “detrimentum” dhe “damnum” me të cilët romakët nënkuptonin zvogëlimin e pasurisë së dikujt në mënyrë të padrejtë apo pengimin e rritjes së pasurisë.²

Në kuptimin juridik me dëm nënkuptojmë dëmtimin e një të mire materiale apo ndonjë interesi tjetër të mbrojtur juridikisht. Dëmi paraqet humbjen e pasurisë, të drejtave dhe dinjitetit të subjektit të së drejtës, si dhe fitimin e munguar që do të mund të realizonte në kushte formale. Në kuptim më të gjerë me dëm nënkuptojmë cënimin e vlerave pasurore të ndonjë personi, cënimin e të drejtave subjektive të tij dhe cënimin e personalitetit të personit. Ndërsa në aspektin

¹G.Galev, D. Anastasovska J- Obligaciono pravo, Skopje, 2012, fq.611.

²N. Dauti- E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.151,

ekonomik me dëm nënkuptojmë zvogëlimin ose humbjen e pasurisë së ndonjë personi për shkak të dëmit të shkaktuar. Nëse marim parasysh kodet e ndryshme theksohet qarte se kemi dy lloje të dëmeve të cilat mund të ju shkaktohen personave të ndryshëm edhe atë dëmi material dhe ai jomaterial(moral).

Dëmi që mund t'i shkaktohet personave apo pasurisë së huaj, mund të jetë natyrave të ndryshme. Kështu, dëmi material është ai lloj dëmi i cili çënon të mirat materiale të personit, të drejtat pronësore apo ndonjë interes tjetër pasuror. Autorë të ndryshëm në vend të dëmit pasuror, për të konkretizuar llojin e dëmit të shkaktuar, përdorin shprehjen dëm material. Ka shumë mënyra të shkaktimit të dëmit material, mund të shkaktohet kur i merret sendi i caktuar ndonjëpersoni, i dëmtohet ose i zhduket si dhe kur çënohet nderi i personit,gjithashtu mund të shkaktohet edhe me rastin e mospërbushjes së ndonjë prestiti obligator nga mardhënjet e detyrimit kur kemi të bëjmë me mospërbushjen e detyrimeve kontraktore.

Dëmet në përgjithësi ndahen në tri kategori: dëme të kopmenzueshme, dëme të ndëshkueshme dhe dëme nominale. Dëmet e kompenzueshme kanë për qëllim që ta kompenzojnë viktimën për humbjet e saj dhe ta rikthejnë gjendjen pasurore të tij në pozitën e para shkaktimit të dëmit. Dëme të ndëshkueshme nënkuptojmë ato dëme ku ndëshkohet i akuzuari për sjellje të pakujdesshme apo të qëllimshme me rastin e shkeljes së ligjit. Dëme nominale kemi atëherë kur ka prova për dëmin e shkaktuar por nuk është vërtetuar se është kaktuar ndonjë pasojë.³

Ç'do herë duhet të bëjmë dallimin në mesë të dëmit sipas mardhënieve detyrimore dhe dëmit në kuptimin e përditshëm. Në kuptimin e përditshëm dëmi do të jetë një humbje pa marrë parasysh natyrën e tij, shembull nëse dikujt i ka ikur ndonjë dark, aheng etj.⁴

Sipas ligjit për mardhëniet detyrimore të Republikës së Maqedonisë Veriore, neni 142, është paraparë që dëmi është zvoglim i pasurisë së dikujt (dëmë i thjeshtë), dhe ndalim i zmadhimit të saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i lëndimit të të drejtave personale.

Dhe kështu dëmi material paraqet zvogëlimin e pasurisë së dikujt ose ndalon zmadhimin e sajë, ndërsa dhimbjet fizike, vuajtjet psikike dhe frika përfaqësojnë dëm jomaterial.

Me termin kompenzimi i dëmit material (pasurorë)kuptohet menjanimi, shpërblimi i dëmit ose zbutja e pasojave të dëmshme si rezultat i dëmit të shkaktuar.⁵

³J. Radisi-Obligaciono Pravo, Sarajevo, 1985. fq.180

⁴L.Milosheviq- Obligaciono pravo , Univerzitet Novi Sad, 1966, fq.106.

⁵K. Cavdar- Praven Leksikon na trgovsko i gragansko pravo, Akademik, Skopje, 2004,fq.401.

1.2. Palët në marëdhëniet detyrimore

Palët në marëdhëniet detyrimore e që shfaqen me shkatimin e dëmit janë: dëmtuesi dhe i dëmtuari. Dëmtuesi është person fizik apo juridik, që përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Personi fizikë mundë të jetë dëmtuesi në rast se është në gjendje të mirë shpirtërore dhe i cili e ka aftësin e veprimit, që ta mund ta kuptojë rëndësin e veprimeve të tij, nga të cilat rrjedh dëmi, apo duhet të ketë aftësi deliktore.⁶

Personi juridik mundë të jetë dëmtues, atëherë kur dëmi është shkaktuar gjatë realizimit të detyrave dhe qëllimeve për të cilat është themeluar.⁷

Ndërsa pala e dëmtuar është personi të cilit i është shkaktuar dëmi i caktuar material ose moral nga autori i dëmit. Ajo paraqitet si palë debitore e cila ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Si palë e dëmtuar mund të jetë edhe personi fizik dhe juridik. Personi fizik duhet të ekzistojë në momentin e shkakimit të dëmit, sepse vetëm në kushte të tilla ajo ka subjektivitetin civilo-juridik.

Përkunder ekzistimit të të dyja palëve, që të egzistojë përgjegjësia deliktore civile për dëmin e shkaktuar duhet të plotësohen keto kushte :

1. Shkaktimi i dëmit,
2. Dëmi të jetë shkaktuar me veprim të kundërligjshëm,
3. Egzistimi i fajit të dëmtuesit,
4. që të ekzistojë aftësia deliktore,
5. që të egzistojë lidhja kausale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Të gjitha këto kushte duhet të egzistojnë për përgjegjësinë subjektive.⁸

Apo, për paraqitjen e marrëdhënieve detyrimore ku shkaktohet dëmi, duhet të ekzistojnë tre kushte : veprimi i dëmshëm, dëmi si dhe lidhja kausale. Këto janë kushtet kumulative dhe duhet ato të ekzistojnë njëkohësisht. Përveç kushteve themelore për paraqitjen e plotë të marrëdhënieve detyrimore duhet të ekzistojë edhe një kusht i vecantë sipas të cilit përcaktohet lloji dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.⁹

⁶Shih, Pop Georgiev D, Obligaciono pravo, Zavod za unapreduvane na stopanstvoto vo SRM, Skopje, 1976, fq.141

⁷Shih, Pop Georgiev D., Obligaciono pravo, zavod za unapreduvawe na stopanstvoto vo SVR, Skopje, 1976, fq.142.

⁸Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.157.

⁹Shih, G.Galev, J.D.Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup 2012, fq.620.

2. LLOJET E DËMIT

Kur dëmi është shkaktuar, duhet të vërtetohet se atë llojë të dëmit a e paranon e drejta apo jo, domethënë duhet të vërtetohet a e pranon e drejta atë shkelje pronësie ose shkelje të së drejtës, gjegjësisht interesave të mbrojtura juridike, me të cilat do të mund të vijë deri te shkelja e të drejtave absolute dhe relative.¹⁰

E drejta jonë pozitive juridike, njeh dy lloje të dëmit:

1. Dëmin material
2. Dëmin jomaterial(moral).

2.1. Dëmi material

Me dëmin material nënkuptojmë dëmin e shkaktuar në të drejtat pasurore të njeriut, Dëmi material ekziston kur pasojat negative nga veprimi i kundërligjshëm manifestohet mbi të drejtat pasurore dhe interesat personale të dëmtuarit, vlera e të cilave mund të shprehet në para. Si dëm i pasurisë llogaritet cdo lloj i zvoglimit të pasurisë së dëmtuarit, si dhe ndalimi apo pengimi që ajo pasuri të rritet, kur një rritje e tillë në realitet ka mundur të bëhet nga puna e rregullt ose kushtet konkrete.¹¹

Pra, dëmi material është cënimi i vlerave materiale të njeriut. Dëmi material ekziston edhe në rastin e cënimit të integritetit fizik të ndonjë njeriu(lëndimit trupor, dëmtimi i shëndetit që ka shkaktuar shpenzime për shërim, humbjen e të ardhurave personale të dëmtuaritose edhe kur shkaktohet vdekja e një njeriu e ajo ndodhë me fajin e dikujt

Si lloje të dëmeve materiale janë edhe :dëmi i vërtet (damnum emergens)dhe fitimi i humbur (lucrum cessans), dëmi abstrakt dhe dëmi konkret, dëmi i drejtëpërdrejtë dhe dëmi i tërthort, dëmi egzistues dhe dëmi i ardhshëm, eventual dhe dëmi i paraparë dhe i paparaparë.

Dëmi i vërtetë (damnum emergens)nënkupton zvogëlimin e pasurisë së tanishme të personit të dëmtuar. Për këtë lloj dëmi përdoren emërtime të ndryshme si dëm real, dëm i thjeshtë, dëm pozitiv, etj. Ky lloj dëmi mund të paraqitet edhe në situata kur dëmi shkaktohet nga delikti apo nga shkelja e detyrimeve kontraktore. D.m.th dëmi i vërtet rezulton nga cënimi i

¹⁰Shih, Qavdar K.Praven leksikonna trgovskoto i gragjanskoto pravo, Skopje, 2004,fq..402.

¹¹Shih, Dukoski Sasa, Obligaciono pravo, Kicevo, 2016.

të drejtës pasurore ose interesit pasuror të të dëmtuarit. Vlerësimi i dëmit të vërtet bëhet në mënyrë të thjeshtë pasi vetëm behet dallimi i vlerës së pasurisë së të dëmtuarit para dhe pas shkakimit të dëmit. Pjesë të dëmit të vërtet paraqesin edhe shpenzimet e bëra nga ana e të dëmtuarit në lidhje me ndërmarjen e veprimeve dhe masave të caktuara me qëllim që të shmanget rreziku nga shkaktimi i dëmit.¹²

Në legjislacionin penal në emër të kompensimit të dëmit mund të kërkoj kompensimin e dëmit material si dëm i vërtet dhe si fitim i humbur. I dëmtuar me anë të kërkesës pasurore juridike mund të kërkoj kthimin e sendit. Psh. Te vepra penale e vjedhjes në qoftë se sendi i marrur është në gjendje të rregullt.¹³

Dëm i vërtet është kur then xhamin e veturës, kur thehet dritarja. Në këto raste është shkakuar dëmi i vërtet me zvoglimin e aktivës së subjektit tjetër.¹⁴

Fitimi i humbur (*lucrum cessans*) është ai lloj i dëmit material që shkaktohet jo në cënimin e vlerave egzistuese pasurore, por në rastet kur i dëmtuari pengohet në rritjen e vlerave pasurore të tij. Për këtë lloj dëmi përdoren gjithashtu edhe shprehje të ndryshme, si fitim i lëshuar, dobi e lëshuar, fitim i humbur etj, por që të gjitha kanë kuptimin e njëjtë. Fitimi i munguar nënkupton atë fitim për të cilin është e sigurt që dëmtuari sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do ta realizojë, në qoftë se debitori detyrimin e vet do ta përmbush ashtu sikunder duhet.¹⁵

Kjo mund të vërehet edhe nga ndarja që bën LMD në nenin 142, kur jep kuptimin e dëmit si zvogëlim të pasurisë së dikujt (dëm i vërtetë) dhe pengimin e rritjes së pasurisë (fitimin e munguar). Në keto raste veprimi i dëmshëm nuk ka për pasojë dëmtimin e të mirave aktuale, por pengimin e rritjes së pasurisë për të ardhmen.¹⁶ Kur vozitësi të taksit i është djegur vetura, në këtë rast vlera e veturës paraqet dëmin e vërtet, kurse fitimi që do ta realizonte taksisti duke kryer shërbime me atë veturë paraqet fitimin e munguar.¹⁷

Demi konkret është ai lloj dëmi që realisht është evident dhe që mund të vërtetohet sipas rregullave konkrete të tregut, të cilat egzistojnë në momentin e shkakimit të dëmit. Lartësia e tij përcaktohet për çdo rast veç e veç në bazë të rrethanave konkrete dhe duhet të vlerësohet me para. Dëmi konkret është vetëm ai dëm të cilin mundet me saktësi ta vërteton pala pretendente.

¹²Shih, Galev G., Jadranka, Obligaciono pravo, Beograd, 2004, fq.215.

¹³Shih, Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.110-111.

¹⁴Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtin, 2001, fq.158.

¹⁵Shih, Galgono, F., E Drejta private, Tiranë, 2003, fq.285.

¹⁶Shih Ligjin për mardhëniet detyimore i Republikës Maqedonisë.

¹⁷Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtin, 2001, fq.158.

Konkretizimi dhe vleresimi i lartesisë së dëmit konkret mund të bëhet duke i përdorur të gjitha mjetet e provës, sic janë: këqyrja në vendin e ngjarjes tek sendi i dëmtuar, dëshmitarët, ekspertin, dokumentet, qoftë publike apo qoftë edhe private, pranimi nga vet shkaktuesi i dëmit, etj.

Dëmi abstrakt është një lloj i dëmit material i cili caktohet në mënyrë abstrakte duke mos marre në bazë dëmin e vërtetë të shkaktuar, duke u caktuar në shumë paushale ose me përqindje.¹⁸ Për dallim nga dëmi konkret ku vështirë përcaktohet lartësia e shpërblimit të tij, dëmi abstrakt është ai lloj dëmi, ka vlerat e detyrimit për kompensim mund të përcaktohet në mënyrë më të lehtë, pasi e njejta dihet paraprakisht dhe nuk varet nga vlera reale e dëmit të shkaktuar. Kjo lartësi parimisht është e përcaktuar në mënyrë paushale. Ky lloj i dëmit material më shumë gjenë shprehje në kontratat e detyrimit dhe në mardhëniet tregtare.

Dëmi direkt është ai dëm, pasojat e të cilit kanë ardhur drejtëpërdrejtë nga veprimi i kundërligjshëm i dëmtuesit apo nga lëshimet eventuale, që sikur t'i kishte ndërmarë nuk do të vinte deri te efektet e dëmshme. Nga dëmi i drejtëpërdrejtë njëkohësisht paraqiten edhe veprimi i dëmshëm edhe efektet e dëmit. Në këtë lloj dëmi veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak i drejtëpërdrejtë i shkaktimit të dëmit.

Dëmi i tërthortë është ai dëm që vjen si pasojë jo e drjtëpërdrejtë e veprimit të dëmshëm me të cilin çënohet pasuria apo ndonjë interes tjetër juridik i të dëmtuarit. Te ky lloj dëmi paraqiten veprimi i dëmshëm apo lëshimi eventual si rrethanë e tërthortë të cilat shkaktojnë pasoja refleksive në më shumë dëme.

Dëmi efektiv është ai dëm material i cili egziston apo është shkaktuar bashkë me pasojat e tij që në momentin e shkaktimit të dëmit. Si zakonisht ky lloj dëmi ekziston kur dikujt i dëmtohet apo i zhduket ndonjë send, kur i shkaktohen lëndime trupore, kur i çënohet nderi apo reputacioni, dhe si rezultat i dëmit të shkaktuar personit i shkaktohet humbje materiale, dhimje fizike, vuajtje shpirtërore apo frike.

Dëmi i ardhshëm është ai lloj dëmi i cili ende nuk është paraqitur, por besohet se me siguri do të shkaktohet, edhe pse nuk dihen saktë kur dhe sa do të jenë pasojat. Paraqitja e sigurtë e pasojave ëdhtëi lidhur me veprimin e dëmshëm që ka shkaktuar dëmi momental ndaj një të mire materiale apo jomateriale, dhe sipas llojit të dëmit besohet në paraqitjen e dëmtimeve shtesë në të ardhmen. Te dëmi i ardhshëm pasoja duhet të paraqitet në një periudhë më të vonshme pas veprimit të dëmshëm, i cili poashtu mund të jetë qoftë me natyrë materiale qoftë jomateriale.

¹⁸Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.159.

Dëmi iparashikuar është ai dëm të cilin ka mundur ta parashohë dëmtuesi, në momentin e marrjes së veprimit të dëmshëm apo lëshimit të veprimit, nga i cili ai është shkaktuar si pasojë e atij veprimi. Ky lloj dëmi përveç nga delikti gjithashtu mund të realizohet edhe me mospermbushjen e kontratës apo me përmushjen jo të rregullt të saj. Kjo ndodhë kur debitori e di saktë se me rastin e mospermbushjes së prestitimit obligator cilat do të jenë pasojat për kreditorin.

Dëmi i paparaparë është ai dëm tek i cili dëmtuesi nuk e ka parapare apo nuk ka mundur ta parashohë shkaktimin e pasojës në momentin e ndërmarrjes së veprimit të dëmshëm. Ky lloj dëmi është shumë prezent tek detyrimet kontaktore, ku ndonjëra nga palët kontraktuese shpesh vjen në situatë të ndryshimit të rrethanave dhe ti vështirsohet apo pamundësohet përmbushja e detyrimit kontraktorë të cilën rrethanë nuk ka mundur ta parashohë.

2.2. Dëmi jomaterial

Dëmi jo material ekziston kur të dëmtuarit i shkaktohet dhembje fizike, vuajtje dhe frikë. Dëmi material çënon të mirat personale të të dëmtuarit siç janë: dinjiteti, autoriteti, prishja e qetësisë personale dhe familjare, cënim i lirisë, shkaktim i dhembjes fizike, psikike, frikës, nderit, i lirisë personale, lirisë së mendimit. Dëmi jomaterial apo moral shkaktohet pavarësisht nga dëmi material, por më së shpeshti paraqitet bashkë me dëmin material, psh. Lendimi trupor, dhimbja fizike, shëmtimi.¹⁹

Sipas Ligjit për mardhëniet detyimore të vitit 2001, ndryshimet e vitit 2008, dëmi jomaterial konsiderohet si cënim i drejtave personale.

Për dallim nga dëmi material i cili vjen si rezultat i dëmit të të mirave materiale, dëmi jomaterial rezulton si rezultat i cënimit të të drejtave jomateriale.

3. PËRGJEGJËSIA DHE LLOJET E PËRGJEGJËSISË SË DËMIT

Është tradicionale të thuhet se kush e shkakton dëmin me fajin e vetë, përgjigjet për

¹⁹Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.159.

dëmin e shkaktuar, por kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme, ekziston përgjegjësia për sendet ose veprimtarit e rrezikshme, apo kur dikush përgjigjet për veprimet e tjetrit, ekziston përgjegjësia për të tjerët. Prandaj dallojmë : përgjegjësin subjektive, përgjegjësin objektive, dhe përgjegjësin për të tjerët.

3.1.Përgjegjësia subjektive

Përgjegjësia subjektive është lloj i përgjegjësis juridike civile, në të cilën personi përgjegjës përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar, me veprimin e tij deliktor dhe ai është fajtor për dëmin e shkaktuar. Ligji mbi mardhëniet e detyrimeve i Republikës së Maqedonisë në nenin 147 parasheh që ai që me fajë do ti shkaktoj dëm tjetrit është i obligueshëm që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar.

3.2.Përgjegjësia objektive

Përgjegjësia objektive për dëmin e shkaktuar është ai lloj i përgjegjësisë deliktore civile që mbështetet në faktin e shkaktimit të dëmit nga sendet e rrezikshme, a veprimtaritë e rrezikshme. Kjo përgjegjësi ndryshe quhet edhe përgjegjësi pa faj, përgjegjësi për sendet e rrezikshme dhe veprimtarit e rrezikshme, si përgjegjësi kauzale ose përgjegjësi që mbështetet në në parimin e kauzalitetit.

3.3. Përgjegjësia për të tjerët

Përgjegjësia për të tjerët është lloji i tretë i përgjegjësis, për dëmin e shkaktuar . Kjo është krijuar në interes të dëmit të subjektit të dëmtuar që ti ofrohet mbrojtje më e mirë ndaj shkaktuesit të dëmit, i cili zakonisht nuk ka mjete që të bëjë shpërblimin e dëmit. Rastet e përgjegjësis për veprimet e tjetrit janë: përgjegjësia e prindërve për fëmijë, përgjegjësia e kujdestarit për të miturin ose e organit të kujdestarisë, përgjegjësia e punëdhënësit për puntorët e vetë, përgjegjësia e organizatës ekonomike për puntorët e vet dhe përgjegjësia e shtetit për dëmin e shkaktuar nga punëtorët në shërbim të shtetit.²⁰

²⁰Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, fq.173-190.

4. FAJI DHE SHKAKTIMI I DËMIT

4.1. Kuptimi fajit

Faji është kusht i përgjegjësis deliktore civile, e nëveçanti i përgjegjësis subjektive, por edhe i përgjegjësis deliktore penale. Disa ligje vetëm konstatojnë se faji ekziston. Faji ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me qëllim ose nga pakujdesia.

Per dallim nga përgjegjësia penale ku faji paraqitet si kusht i domosdoshëm për egzistimin e përgjegjësisë, pa të cilin nuk ka dhe santon penal, te përgjegjësia civile faji nuk paraqet kushtin e domosdoshëm të lindjes së përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, sepse te përgjegjësia civile ekzistojnë situata kur përgjegjësia lind edhe pa faj, siç është rasti me përgjegjësi objektive, që ndryshe quhet përgjegjësia pa faj (përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme).

Nocioni i përgjegjësis penale është identik me nocionin e fajit. Në pikpamje bashkohore përgjegjësia penale është bazuar në parimin e fajit. Pra nuk ka veprër penale, nuk ka dënim pa faj.²¹

4.2. Shkaktimi i Dëmit

Faji paraqet elementin e brendshëm subjektiv të përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, pasi kjo është një marrëdhënie në mes vullnetit të dëmtuesit, veprimit të dëmshëm dhe pasojave që shkaktohen nga veprimi i personit. Shkaktuesi i dëmit, kur dëmin e kryen me faj, do të përgjigjet jo për faktin e shkaktimit të dëmit, por për vendimin e tij të brendshëm psikik që ka sjellë në shkaktimin e dëmit. Dispozitat e ligjit nuk japin kuptimin e fajit, pasi këtë e bën doktrina juridike. Megjithatë në nenin 141 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore të Republikës së Maqedonis Veriore përmendet çështja e fajsisë ku thuhet: "Ai i cili do të shkaktonte dëm tjetrit është detyruar që ta zhdëmtojë, përderisa nuk është në gjendje ta dëshmon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij". Në këtë ligj përjashtohen rastet kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, ku subjekti përgjigjet edhe pa faj.

²¹ Shih, Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.124.

4.3.Mënyrat e shkaktimit të dëmit

Sipas peshës sëfajita, faji mundë të jetë i shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia. Sipas legjislacionit tonë të Republikës së Maqedonis Veriore parashihet që faji ekziston kur i dëmtuari ka shkaktuar dëm me dashje ose nga pakujdesia.²²

Sipas Kodit penal përgjegjësi penale ka kryerësi i cili është i përgjegjshëm dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.²³

Dashja është shkalla më e rëndë e fajit, që paraqitet kur dëmtuesi me qëllim i shkakton dëm tjetrit. Në këtë rast dëmtuesi dëshiron dhe di pasojat e dëmshme të veprimit të vetë ose mosveprimit të vetë. Pakujdesia nga ana tjetër është shkallë e fajit që prezumon një lloj sjellje të parregullt të dëmtuesit. Pakujdesia përcaktohet në mënyren abstrakte në mbështetje të standardeve të sjelljeve të njerëzve sic, janë: sjellja e njeriut si ekonomist i mirë, si shtëpiak i mirë, kujdesi i njeriut të rëndomtë. Format e pakujdesiis janë : pakujdesia e rëndë dhe pakujdesia e lehtë.²⁴

4.4.Aftësia deliktore

Aftësia deliktore ose e përgjegjësisë është aftësia e një subjekti që ti kuptojë veprimet e veta. Aftësia deliktore arrihet me arritjen e moshës madhore. Sipas ligjit për mardhëniet detyrimore të vendit tonë, neni 147, i mituri deri në moshën 7 vjecare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, mituri prej moshës 7 vjecare deri në moshën 14 vjecare, nuk përgjigjet për dëmin, përveç në qoftë se vërtetohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për gjykim, dhe i mituri mbi moshën 14 vjecare përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin. Aftësi deliktore kanë edhe personat fiyik dhe juridikë.

Aftësia deliktore për shkaktim dëmi nga persona fizik paraqitet si kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë jashtëkontraktore. E theksojmë në mënyrë të veçantë vetëm përgjegjësinë jashtëkontraktore, pasi te përgjegjësia kontraktore, aftësia e palëve përveç se paraprakisht nënkuptohet (nuk mund të jenë palë në kontratë personat pa zotësi veprimi) dhe se të drejtat dhe

²²Shih, Ligjin për mardhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë , Gazeta Zyrtare e R.M. nr.18, viti 2001, neni 145.

²³Shih, neni 11 paragrafi 1 I Kodit penal të Republikës së Maqedonisë..

²⁴Shih, Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtine, 2001, fq.165-167.

detyrimet lindin vetëm për subjektet e kontratës – inter partes, ku si subjekte, personat fizik mund të jenë vetëm të moshës madhore, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Përgjegjësin e plotë për të vepruar me mbushjen e moshës madhore, gjegjësisht 18 vjeçare. Në këtë rast aftësia deliktore e këtyre personave, e cila është ngushtë e lidhur me fajin supozohet. Në të kundërtën duhet të jenë të përfaqësuar nga persona me zotësi të plotë për të vepruar. Aftësia deliktore paraqet aftësinë e personit fizik që të përgjigjet vet për pasojat e veprimeve të tij, në qoftë se me këto veprime i ka shkaktuar dëm personit tjetër, pavarësisht a nëse lind përgjegjësia penale apo vetëm ajo civile. A do të përgjigjet personi për shkaktimin e dëmit, kjo varet nga mosha dhe aftësia e të gjykuarit. Jo të gjithë personat me arritjen e moshës madhore e fitojnë zotësinë e veprimit dhe aftësinë deliktore, pasi ka persona që e kanë të kufizuar apo u është hequr fare zotesia e veprimit për shkak të sëmundjeve shpirtërore, ngecjes në zhvillimin mendor apo të të metave tjera psikike. Kjo kategori e personave nëse e kanë të hequr zotësinë e veprimit nuk do të përgjigjen për veprimet e tyre. “Personi që për shkak të sëmundjeve psikike apo për shkak të ngecjeve në zhvillimin mendor apo pavarësisht arsyeve të tjera nuk është i aftë për gjykim nuk do të përgjigjet për dëmin që do t’ia shkakton tjetrit” (neni 146 I LMD-së). Në praktikë mund të ndodhë që personi të shkakton dëm në gjendje të dehur apo droguar, në këtë rast, sipas të drejtës tonë këto persona nuk mund të lirohen nga detyrimi për zhdëmtim duke u thirrur në gjendjen në të cilën ka qenë, i pavetëdijshëm për të gjykuar në momentin e shkaktimit të dëmit. Sipas paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 146 të LMD-së, në qoftë se personi ka shkaktuar dëm në gjendje të paafësisë së përkohshme për të gjykuar, do të përgjigjet për dëmin, përveç se nëse provon që në atë gjendje ka ardhur pa fajin e tij. Personi me fajin e të cilit ka ardhur në këte gjendje do të përgjigjet për pasojat e dëmit.

Ndërsa, aftësia deliktore për shkaktim dëmi nga personat juridik paraqitet si kusht i përgjithshëm për lindjen e përgjegjësisë deliktore. Personat juridik që të përgjigjen për dëmin e shkaktuar duhet të posedojnë aftësi deliktore, dhe këtë aftësi e fitojnë në momentin e themelimit ose regjistrimit të tyre në shtetin amë. Karakteristike e tyre është se përgjegjësia e tyre haset tek dëmi që të punësuarit e personit juridik ose organet që kryejn veprimtari të caktuar, personit të tretë i shkaktojnë dëm.²⁵

²⁵Shih, Ligjin për Mardhënie detyrimore të RM, neni 157-158.

4.5. Pasojat nga shkaktimi i dëmit

Shkaktimi i dëmit ka edhe pasojat e tij. Dëmi është humbje e të mirave materiale të cilat janë të mbrojtura, por edhe humbje e pasurisë. Dëmi material ka për pasojë cenimin e pasurisë së të dëmtuarit, në kuptimin e ngusht ekonomik, pra humbjen ose pakësimin e pasurisë. Dëmi material paraqet humbjen e pësuar të pasurisë si dhe fitimin e humbur si pasojë e aksidentin, veprës penale etj. Te rasti për shkak të vdekjes së bashkëfamiljarit, mbajtja e humbur e anëtarëve të familjes kompenzohet nëpërmjet të pagesës së rentës mujore (pagesë mbi baza mujore), të vlerës që do të fitohej në çdo muaj nëse vdekja nuk do të kishte ndodhur, ose të pagesës së përm menjëhershme të të gjitha rentave të ardhëshme.

Ose në qoftëse lënduari përshkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose mundësitë e zhvillimit dhe përparimit të tij të mëtejshëm janë humbur ose janë pakësuar, siguruesi ka për detyrë ti paguaj të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm. Humbja e fitimit duhet të provohet me dokumentacion nga personi i lënduar.

KAPITULLI I DYTË

1. PADIA PËR KOMPENZIMIN E DËMIT

Padia është e drejtat e personit (paditësit), ti paraqes gjykatës pretendimet e tijë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Padia paraqitet me shkrimë në formen e një kërkesë, ndryshe quajtuar kërkes padia ku paditësi cilëson pretendimet e tij. Padia është veprimi i parë procedural me të cilën vihet në veprim procesi kontestimor. Në Republikën e Maqedonisë Veriore kjo është rregulluar në nënin 175 të Ligjit për procedurën kontestimore. Procedimi civil vihet në lëvizje me parashtrimin e padisë si akt hyrës (fillestar) procedural, në të cilin theksohet një kërkesë e caktuar pa marrë parasysh se si kuptohet ai termin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.²⁶ Kërkesëpadia - (Petitumi). Me anë të kërkesëpadisë paditësi e formulon mendimin se si duhet të duket dispozitivi i aktgjykimit me të cilin pranohet ajo.²⁷

1.1. Paraqitja e padisë

Si rregull padia ngrihet në gjykatë ku i padituri ka venbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme. Kur i padituri është person juridik, padia ngryhet në gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij. Kërkespadia paraqitet nga në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë, siç mund të jetë avokati . Ajo mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës. Nëse kërkesa ka të meta gjyqëtari i cakton paditësitnjë afat për plotësimin e tyre. Nëse paditësi i plotëson të metat brenda afatit, padia quhet e regjistruar që nga data kur ajo është e paraqitur. Në të kundërtën kërkespadia quhet se nuk është paraqitur, dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.²⁸

Për padin paguhet taksamenjëhere në fillim. Nëse nuk kemi mjete për pagimin e taksës,

²⁶Shih, Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009, fq.17.

²⁷Shih, Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.147 .

²⁸ww.njohligjin.al

mund t'i bëjmë kërkesë gjykatësit që t'na lirojë nga pagesa, sepse sipas gjendjes sonë ekonomike nuk kemi mundësi të paguajm. Për gjithçka që thoni duhet të keni prova. Si rregull nëse nuk keni prova kontesti do të humbasni. Provat janë: Dokumentat (p.sh. kontratat, fletëllogaritë, faturat, çertifikat e lindjes, shkrimet, mail-et, dëshmitarët – adresën e të cilëve duhet ta përmendni, ekspertimi – që do ta caktojë gjykata, hetimi – që përdoret rallë në kontest). Ju propozoni dhe dorëzoni prova. Propozimi do të thotë se i përmendni qartë në padi (p.sh. nëse thoni se dikush Ju ka borxh dhe keni dëshmitarë, propozoni prova: me dëgjimin e dëshmitarit P. P. Nëse keni fletëllogari, propozoni provë: fletëllogaria nga data 05.05.2010 por kopjon e fletëllogarisë e dorëzoni në disa kopjo, dhe e dorëzoni bashkë me padinë. Është shumë e rëndësishme që të caktoni saktësisht se çfarë doni nga gjykata. Kjo quhet “formulacioni i kërkesë padisë”. Kjo është pyetja kryesore në procesin gjyqësor. Sipas rregullit, ai formulohet pasi përshkruani ngjarjen/situatën për të cilën bëtë padinë, dhe keni shpjeguar përse ju takon e drejta.²⁹

Ekzistojnë kritere të ndryshme për klasifikimin e padive, por kriteri më i pranuar është kriteri varësisht nga tipi dhe përmbajtja e mbrojtjes juridike që kërkohet me to. Sipas këtij kriteri kemi tri lloje të padive: padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi.

1.2.Legjitimimi aktiv dhe pasiv

Palët në një proces duhet të kenë legjitimitimin për të parashkruar një kërkim në gjykatë ose për të kundërshtuar këtë kërkim, është e domosdoshme që ato të kenë një interes të ligjshëm. Gjykata për të hetuar nëse personat fizikë apo juridikë të cilët i janë drejtuar gjykatës me kërkesë-padi ose me kërkesë gëzojnë legjitimitetin aktiv, verifikon nëse kanë apo jo interes të ligjshëm në paraqitjen e kërtimeve. Në ligjin për procedurë civile parashikohet që padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur, për vërtetimin e qenies apo mosqenies së një marrëdhënie juridike ose një të drejte, si dhe për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti.³⁰

Interesi legjitimim ka të bëjë me faktin se paditesi mund të ushtroje të drejtën e padisë vetëm kur atij i është cënuar, mohuar apo shkelur një e drejtë që atij i është njohur me ligj(

²⁹ Shih, Udhëzues-për herë të parë në gjykatë dhe për herë të parë në gjykim, YUCOM, komitet pravnik za ljudska prava, Beograd.

³⁰ Shih, neni 177, paragrafi 1, I Ligjit për procedurë civile të RM, Skopje, 2006.

legjitimacioni aktiv) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv).

Palën në çdo proces gjyqësorë kërkohet të provojë ekzistencën e tri kushteve:

1. Të ketë zotësi për të qenë palë (zotësia e palës);
2. Të ketë zotësinë e kryerjes së veprimeve të caktuara (zotësia procedurale);
3. Të vërtetojë lidhjen e domosdoshme midis interesit të palës dhe çështjes konkrete (ligjshmëria e palëve). Këto janë dhe kushtet e domosdoshme për legjitimimin aktiv ose pasiv të palëve në padinë për shpërblimin e dëmit jomaterial Në procesin gjyqësor për kërkimin e shpërblimit të dëmit jopasuror, si në të gjithë mosmarrëveshjet gjyqësore-civile ekzistojnë pala paditëse dhe pala e paditur, duke formuar ndërgjyqësin kur palët legjitimohet aktivisht dhe pasivisht. Në mënyrë që pala kërkuese të legjitimohet aktivisht, do bëjmë dallim mes kërkesës për shpërblimin e dëmit ndaj shëndetit dhe atij që ka shkaktuar vdekjen. Në rastin e dëmtimit të shëndetit, legjitimim aktiv ka vetë personi i cenuar në shëndetin e tij dhe, sipas rrethanave, edhe pjesëtarët e afërt të familjes së tij. Në rastin e shkaktimit të vdekjes nga fakti i paligjshëm, kanë legjitimim aktiv për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit material e jomaterial të pësuar pjesëtarët e familjes së viktimës. Në të dy rastet, legjitimim aktiv gëzon edhe personi që pretendon se bashkëjetonte me viktimën pa lidhur martesë me të (*more uxorio*) dhe, në rrethana përjashtimore, edhe persona të tjerë në lidhjen më të afërt të gjinisë a krushqisë me viktimën. Në këtë mënyrë rrethi subjekteve që legjitimohet aktivisht për të kërkuar shpërblimin e dëmit në rastin e vdekjes është më i gjerë sesa tek dëmtimi i shëndetit.

Çdo subjekt i cënuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv për të kërkuar (*ius proprius*) dëmshpërblimin e dëmit material e jomaterial të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar, nga fakti i paligjshëm.³¹

Pala ndaj të cilit drejtohet kërkesa për shpërblimin e dëmit, legjitimohet pasivisht, nenit 141 të Ligjit për mardhënie detyrimore ne vendin tonë, parashikon që “Ai që do të shkaktoj dëm tjetrit, detyrohet ta shpërblejë dëmin, përderisa nuk vërtetohet që dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja

³¹ <https://studioligjore.wordpress.com/2011/12/06/>

shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.

1.3.Afatet për paraqitjen e padisë

Afat në kuptimin procedural është koha (intervali) brenda të cilit duhet të ndërmeret një veprim procedural. Poqëse pjesmarrësi procedural nuk ndërmer ndonjë veprim procedural brenda afatit të caktuar, sipas rregullit, e humb të drejtën e ndërmarrjes së mëtëjshme të atij veprimi. Pasi varësisht nga lloji i çështjes juridike për të cilën vendos gjykata , ekzistojnë lloje të caktuara të procedurës gjyqësore edhe ate procedura penale, kontestimore, jashtkontestimore dhe procedura e përmbarimit.³² Meqë hulumtimi ka qenë kryesishtë lidhur me kompenzimin e dëmit material në Gjykatën Shkupi 1 Shkup, duhet cekur se kërkësën të cilën ka të drejtë ta paraqes dëmtuari në procedurën penale lidhur me kompenzimin e dëmit material apo kërkesa pasuroro juridike mund ta paraqesë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor. Edhe pse zgjidhja e ceshtjeve pronësore juridike është objekt i procedurës civile dhe zgjidhet në procedurën kontestimore.

³²Shih, Kurtesh Saliu, E drejta Kushtetuese, libri I, Prishtinë, 2001, fq.252.

2. SHPËRBIMI I DËMIT

Detyrimi për shpërblimin e dëmit paraqitet si sanksion, që në momentin e lindjes së përgjegjësisë. Detyrimi për shpërblimin e dëmit bije mbi personin përgjegjës që ka shkaktuar dëmin. Bazuar në rregullat e së drejtës kur dikush dikujt i shkakton dëm është i detyruar që t'ia shpërblej dëmin e shkaktuar në rast se plotësohen kushtet e caktuara. Duke shpërblyer dëmin e shkaktuar synohet që të vendoset ajo gjendje që ka egzistuar para momentit të shkakimit të dëmit. Edhe sot gjykatësi me rastin e sjelljes së vendimit për shpërblimin e dëmit i referohet asaj që është e drejtë objektive në një vend, duke marrë për bazë plotësimin e kushteve për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar me çrast lind edhe detyrimi i dëmtuesit për shpërblimin e dëmit. Bazë e përgjegjësisë për detyrimin për shpërblimin e dëmit të nje personi të caktuar është vetë fakti i shkakimit të dëmit. Kjo parashihet edhe me nenin 141 të LMD-se sipas të cilit ai cili i shkakton dëmin tjetrit është i detyruar që ta shpërblej. Qëllimi i detyrimeve nga shkaktimi i dëmit është shpërblimi i dëmit pasuror që ka pasur i dëmtuari.

Në bazë të praktikës gjyqësore vërejmë se janë shumëfishuar rastet e kontesteve që zhvillohen pranë gjykatave për shpërblim të dëmit. Edhe në Maqedoni numri me i madh i kontesteve civile kanë për bazë shpërblimin e dëmit. Ketë mund ta konstatojmë në qoftë se vërejmë raportin e lëndëve civile në Gjykatën Themelore Civile Shkup. Poashtu në Gjykatën themelore Penale Shkup ka një numër të madhë të lëndëve ku gjykata përpos që vendos për cështjen kryesore, vendos edhe për kompenzimin e dëmit material.

Kur flasim për shpërblimin e dëmit theksojmë se dëmi material mund të paraqitet në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, e kjo domethënë në rast të lëndimit të të drejtave të njeriut, lidhur me egzistimin e integritetit trupor, por vetëm kur ai lëndim ka pasoja material juridike të cilat paraqiten si dëm material.³³

Realizimi i këtyre të drejtave bëhet në kuadër të Gjykatës civile, me anë të parashtrimit të kërkesës për shpërblim. Kur flasim për shpërblimin e dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit material hynë harxhimet që i dëmtuari ka pasur për mjekim dhe harxhimet lidhur me mjekim. Te rasti i shpërblimit të dëmit material për shkak të vdekjes, hynë harxhimet në lidhje me varrosjen.

³³ Shih, G. Galev, J.D. Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2012.

PJESA E DYTË
KOMPENZIMI I DËMIT MATERIAL NË REPUBIKËN E
MAQEDONISË VERIORE GJEGJËSISHT NË
GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP NGA VITI 2015 E
KËNDEJ
KAPITULLI I PARË

1.KOMPENZIMI I DËMIT MATERIAL NË GJYKATËN SHKUPI

1 SHKUP

Kompenzimi është një nga mënyrat e shuarjes së marëdhënjeve detyrimore. Ajo çon deri te shuarja e plotë e dy detyrimeve, ose te shuarja e plotë e njërit dhe shuarja e pjesëshme e detyrimit tjetër. Deri te kompenzimi mund të vijë atëhere kur mes palëve të njëjta ekzistojnë detyrime të ndryshme, nga të cilat për ato palë dalin detyra dhe të drejta kolerative, në atë mënyrë që të drejtës së njëres palë i përgjigjet detyra e palës tjetër dhe anasjelltas.

Kur flasim për kompenzimin e dëmit material në Gjykatën themelore Shkupi 1 Shkup, duhet theksuar faktin se kur për zgjedhjen e çështjes penale, nevojitet që gjykata të marrë vendim edhe për disa çështje tjera, të cilat po të mos ekzistonte vepra penale, fare nuk do të shqyrtoheshin në kuadër të procedurës penale. Meqë për vendosjet në kuadër të procedurës së filluar si psh. Kërkesa pasuroro juridike , çështjet prejudikuese, çështjet e procedurës penale që njëherit janë edhe objekt sekundar i procedurës penale.³⁴ Nga kjo lind edhe raporti në mes të dyja procedurave penale dhe civile.

Në të vërtetë e drejta procedurale penale i lejon mundësin personit të dëmtuar me vepër penale të kërkojë që krahas vendosjes së sanksionit penal të vendos edhe për kërkesën pronësore juridike e cila rrjedh nga vepra penale, e sidomos për shkaqe praktike të ekonomizimit procedural mund të zhvillohet procedurë për kompenzim të dëmit. Kështu pra veprimtaria gjyqësore lidhur me kërkesën pasuroro juridike të të dëmtuarit zhvillohet në kuadër të procedurës penale, në procedurën e ashtuquajtur procedurë ad-hezione-procedurë e bashkangjitur e cila i bashkangjitet procedurës penale.³⁵

1.1. Bazat e kompenzimit të dëmit material në Gjykatën Shkupi 1 Shkup

Standardet evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë parapaë që të dëmtuarit duhet ti vihenë në dispozicion të gjitha procedurat për realizimin e të drejtës së kompenzimit të dëmit, në mënyrë të drejtë dhe efikase. E drejta e jonë e parasheh se i dëmtuari mund të kërkojë kompenzimin e dëmit material në përputhshmëri me procedurën penale me vetë parashtrimin e

³⁴Shih, Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq.55.

³⁵Shih, Dr.Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zajneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.24.

kërkesës për kompenzim e që legjislacionin tonë njihet si Kërkesa pasuroro juridike.³⁶

Gjykata me rastin e vendosjes së kërkesës pasuroro juridikekrahassë vendosjes së çështjes penale zbaton Ligjin për procedurë penale të vendit tonë. Meqë me veprën penale të dëmtuarit mund ti shkaktohet dëm material dhe moral i dëmtuari ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës pasuroro juridike të kompenzimit të dëmit. Kërkesa pasuroro juridike është e rregulluar në Ligjin e procedurës penale të Republikës së Maqedonisë, neni 114 ku në paragrafin:

1. është paraparë se Gjykata vendosë për kërkesën pasuroro juridike;
2. Me aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, gjykata plotësisht ose pjesërisht vendos për kërkesën pasuroro juridike, ndërsa për shumën e pjesës së mbetur të kërkesës pronësoro-juridike, e udhëzon personin e dëmtuar qa ta realizoj në kontest. Nëse provat në procedurën penale nuk japin bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë apo të pjesërishtëm të kërkesës pronësoro juridike, e poqëse ato do të procedoheshin do të shkaktohej prolongim i paarsyeshëm i procedurës penale, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasuroro juridike ta realizoj në kontest.
3. Kur gjykata merr aktgjykim me të cilën i akuzuari lirohet nga aktakuza, ose me të cilën aktakuza refuzohet, ose kur me vendim do të pushojë procedura penale, do ta udhëzoj të dëmtuarin që kërkesën pronësoro juridike ta realizoj në kontest. Kur gjykata do të shpallet jokompetente për realizimin e procedurës penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pronësore juridike mund ta paraqes në procedurën penale e cila do të fillohet dhe vazhdohet nga gjykata kompetente.

Edhe pse gjatë analizave të bëra të aktgjykimeve nga Gjykata Shkupi 1 Shkup, gjykata kryesisht për kërkesën pasuroro juridike vendos në pajtim me nenin 114 të Ligjit për procedurë penale, mirpo në Ligjet e mëhershme sidomos Ligji i procedurës penale të Republikës së Maqedonisë nr.15/2005, ku çështja e kërkesës pasurore juridike rregullohej në mënyrë specifike, dhe fakti se Ligji i mëparshëm i procedurës penale zgjedhjes së kërkesës pasuroro juridike e rregullonte në nenin 102 nuk ish funksional , na jep të kuptojm se nuk ish funksional edhe në praktik. Psh. Rast nga praktika gjyqësore është rasti kur i akuzuari R.K, nga SH., shpallet fajtorë për vepër penale Vjedhje të nenit 235 paragrafi 1 i Kodit penal, me çrast i shqiptohet masë alternative dënim me kushtë, dënim i caktuar me burg prej 3 muajve, dhe se e njejta nuk do të

³⁶Doracak , për Ligjin e procedurës penale, Janar, 2012, Shkup, fq.88.

ekzekutohet përderisa i akuzuari , në afat prej 1 viti, nuk kryen vepër penale. Ndërsa lidhur me kërkesën pasuroro juridike ka obliguar të akuzuarin në pajtim me nenin 102 të Ligjit për procedur penale, ti paguaj EVN Elektroekonomia e Maqedonisë, shumën prej 144.428,00 denarë, në afat prej (10 dhjet) muajve.³⁷

1.2. Mënyrat e kompensimit të dëmit material në Republikën e Maqedonisë Veriore

Në kreun XI të Ligjit për procedurë penale është paraparë se kërkesa pasuroro juridikesi rrjedhë e veprës penale vendoset në procedurë penale me propozimin e personave të autorizuar, nese kjo nuk zvarrit procedurën në mënyr të konsiderueshme. Kërkesa pasuroro juridike mund të paraqitet për kompensimin e dëmit material, kthimin e sendit ose prishjen e veprimit juridik. Se kërkesën pronsoro juridike nga neni 2 në rast të sigurimeve, i dëmtuari mund ta parashtroj edhe ndaj kompanis së sigurimit.³⁸

Në emer të kompensimit të dëmit i dëmtuari mund të kërkojë kompensim si të dëmit material (dëmin real- damnum emergens), fitimin e humbur (lucrum cesans) e po ashtu kompensimin e dëmit moral i cili katë bëjë me lëndimin e ndonjë të mire personale, nderit, prestigjit, përjetimit të dhimbjeve fizike ose shpirtërore etj.

I dëmtuari me kërkesën pasurore juridike mund të kërkojë kthimin e sendit (psh. Te vepra penale e vjedhjes,(neni 235 I KP I RM), në qoftëse sendi i marrurr është në gjendje të rregullt. Ska dyshim se i dëmtuari edhe në këtë rast mund të kërkojë kompensimin e dëmit mirëpo, duke patur parasysh faktin se sendi i marrur me rastin e kryerjes së veprës penale mund të ketë vlerë të posacme për të (sepse psh. Orën që iështë vjedhur e ka kujtim prej ndokujt dhe atë nuk kishte për ta dhënë as për shumëfishin e vlerës së sajë), ai mund të mos jetë i kënaqur me kompensimin e dëmit . Prandaj LPP i njeh mundësin që të kërkojë kthimin e sendit.³⁹

Kërkesën pronësoro juridike në procedurën penale mund ta paraqet personi i autorizuar për paraqitjen e kërkesës.⁴⁰

Propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike i paraqitet organit të cilit i paraqitet kallëzimi penal, ose gjykatës në të cilën zhvillohet procedura. Propozimi mund të

³⁷ Aktgjykimi P.nr. 2423/09 i Gjykatës Shkupi 1 Shkup.

³⁸ Shih, Ligjin për procedurë penale, neni 110, paragrafi 1,2,3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150, e dt.18.11.2010.

³⁹ Shih, Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.111.

⁴⁰ Shih, Ligjin për procedur penale , Gazeta Zyrtare e RM , nr.150, tw dt.18.11.2010, neni 111, paragrafi 1.

paraqitet deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë në gjykatë të shkallës së parë. Kur personi i autorizuar nuk ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në kohën e ngritjes së akuzës, njoftohet se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Është me rëndësi të theksohet se personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit ka për detyrë që të shënojë qartë kërkesën e vet dhe të paraqesë prova për vërtetimin e saj (neni 112 I LPP).

Nga çka u tha më lartë del se kur paraqitet kërkesa pasurore juridike për zgjedhjen e çështjeve penale, në procedurë penale, gjykata krahas ndriçimit të çështjes penale, të ndriçojë edhe të dhënat të cilat kanë të bëjnë me kërkesën pasurore juridike dhe në fund të vendos edhe lidhur me këtë kërkesë. Kjo është njëherit e ashtuquajtura procedura ad-hezione apo procedura e bashkangjitur me procedurën penale. Rrjedhimisht në Ligji për procedurë penale kërkon nga gjykata penale që ta zgjidhë edhe kërkesën pasurore juridike. Mirpo në qoftë se zgjidhja e sajë zvarrit procedurën penale në mënyrë të konsiderueshme, e në anën tjetër çështja penale është ndriçuar, atëherë gjykata penale vendos për çështjen penale ndërsa të dëmtuarit me kërkesën pasurore juridike e udhëzon në kontest civil.⁴¹

Në bazë të LPP, me qëllimin e mbrojtjes së të dëmtuarit, për të cilin prioritet ka vendimi për kërkesën pasurore juridike, është parapar[edhe detyra e prokurorit që krahas propozimit marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe krahas provave tjera të mbledhura, detyrimisht duhet të paraqet edhe deklaratën e të dëmtuarit lidhur me kërkesën pasurore juridike, e cila duhet të jetë e shkruar dhe nënshkruar nga ana e të dëmtuarit, edhe atë lidhur me llojin dhe lartësinë e asaj kërkesë. Dhe në bazë të deklaratës shkruhet edhe rasti eventuale i arritjes së marrëveshjes lidhur me kërkesën pasurore juridike. Në legjislacionin penal të vendit tënë, se si kërkesa pasurore juridike mund të paraqitet si kërkesë për dompenyim dëmi me rastin e kryerjes së veprës penale vendoset në ato raste kur nuk zvarritet procedura penale.⁴²

Pra gjykata edhe kur merr aktgjykim dënues, lirues ose refuzues, kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurë penale e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën mund ta paraqesë në procedurë penale, e cila do të fillohet ose do të vazhdohet nga gjykata kompetente.

Rastet kur gjykata merr aktgjykim dënues dhe në të njëjtën kohë e udhëzon palën e dëmtuar në kontest civil është psh. Rasti nga praktika gjyqësore kur gjykata penale Shkup, shpall

⁴¹ Shih, Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.112.

⁴² Doracak për Ligjin për procedurë penale, Janr, 2012, Shkup, fq.88-89.

fajtor të akuzuarit V.B, D.T. dhe C.B, i shqipton dënim me kushtë –burgim deri në 3 muaj, i cili vendim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 viteve, nga dita kur aktgjykimet ka marr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa të dëmtuarin M.B. e udhëzon që kërkesën pronësore juridike ta realizoj në procedurë civile.⁴³

Rastë kur gjykata merr aktgjykim lirues dhe në të njëjtën kohë e udhëzon palën që kërkesën pasuroro juridike ta realizoj në kontest civil, kemi rastin nga praktika gjyqësore kur gjykata themelore Skupi 1 Shkup, për shkak të veprës penale – dëmtimi i të drejtave të huaja të nenit 244 paragrafi 2 të Kodit penal, Gjykata kaloi akuzuarin për veprën e tillë penale por në të njëjtën kohë e udhëzoi palën e dëmtuar Ndsërmarrjen për prodhimin dhe distribuimin e vajrave motorike F.M. Dooel prej SH., që kërkesën pasuroro juridike të parashtruar, në shumën prej 90.000,00 denarësh ta realizoj në kontest civil.⁴⁴

⁴³ Aktgjykim P.nr.1165/13 i Gjykatës Shkupi 1 Shkup.

⁴⁴ Aktgjykim P.nr.47/11 i Gjykatës Shkupi 1 Shkup

KAPITULLI DYTË

1.TË DHËNA STATESTIKORE NË LIDHJE ME KOMPENZIMIN E DËMIT MATERIAL NGA PRAKTIKA GJYQËSORE NË GJYKATËN THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP

1.1.Të dhëna statistikore në lidhje me realizimin e instituteve të ndryshme juridike penale prej vitit 2015-2018.

Për shkak të numrit të madhë të lëndëve në Gjykatën Shkupi 1 Shkup, lëndët në këtë gjykatë janë të regjistruar në institute të ndryshme, dhe lëndët ku gjykata krahas çështjes penale vendos edhe për kërkesën pasuroro juridike të palëve janë të regjistruara në këto institute juridike si më poshtë, dukepatur parasysh se sistemi AKMIS apo programi me të cilën gjykata punon, funksionon nuk bëhet dallimi mes atyre lëndëve ku vendoset për kërkesën pasuroro juridike apo kur pala udhëzohet për realizimin e kësaj kërke.

Prandaj, në këtë tabelë kam paraqitur disa institute juridike ku gjykata ose ka vendosur për kërkesën pasuror juridike për kompenzim të dëmit material ose ku gjykata ka udhëzuar palën që kërkesën e saj pasurore juridike ta realizoj në kontest, e veçanërisht kamë paraqitur statistikën për aktgjykimet që kanë marrë formë të prerë që nga viti 2015 deri në vitin 2018.

	Baza juridike	2015	2016	2017	2018
1.	Lëndim trupor	39	29	23	31
2.	Vjedhje grabitqare	5	5	2	7

3.	Lëndim i rëndë truporë	65	44	44	51
4.	Dhuna	105	75	71	60
5.	Dhunimet	4	3	2	1
6.	Kërcënimi me mjet të rrezikshëm gjatë rrahjeve	20	15	6	11
7.	Vepra të rënda kundër sigurisë së njeriut dhe pasurisë në komunikacion.	7	7	4	5
8.	Vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme shoqërore	15	11	8	18
9.	Privimi i kundërligjshëm i lirisë	7	9	1	1
10.	Rrezikimi i sigurisë së komunikacionit	24	17	27	16
11.	Sulm seksual mbi të miturit	4	3	/	3 ⁴⁵

Tabela nr.1

Pra, siç mundë të shohim nga tabela e paraqitur shohim se në vitin 2015, dominojnë lëndët që kanë të bëjnë me dhunën në familje pra gjithsej janë evidentuara në programin Akmis 105 lëndë ku gjykata më së shumti ka udhëzuar palën që të drejtën e kompensimit të dëmit të shkaktuar ta realizoj në kontest civil, në vitin 2016 gjithsej janë përfunduar 75 lëndë, në vitin 2017 gjithësej 71 lëndë , dhe në vitin 2018 janë përfunduar gjithsej 60 lëndë apo kemi të bëjmë me aktgjykimet e plotfuqishme. Pas dhunës shohim se për nga numri I aktgjykimeve të

⁴⁵Të dhëna statesikore të marra nga Gjykata Shkupi I Shkup, lidhur me aktgjykimet e plotëfuqishme prej vitit 2015-2018.

plotëfuqishme lëndët lëndim I rëndë trupor dominojn edhe ate në vitin 2015 gjithsej aktgjykime të plotëfuqishme kemi 65, në vitin 2016 kemi 44 aktgjykime të shpallura , në vitin 2017 gjithashtu 44 aktgjykime dhe në vitin 2018 kemi 51 aktgjykime që kanë marrë formë të prerë , pra ku gjykata ka udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil apo ka vendosur lidhur me kërkesën e saj pasuror juridike. Pas këtyre veprave më pas janë rradhitur veprat penale lëndim trupor kun ë vitin 2015 aktgjykimet që kanë marrë formë të prerë janë gjithsej 39, në vitin 2016 janë gjithsej 29, në vitin 2017 gjithsej 23 aktgjykime , në vitin 2018 kemi gjithsej 21 aktgjykime të forms së prerë ku gjykata ka vendosur për kërkesën pasuror juridike apo palën e ka udhëzuar në kontest civil. Më pas vijojnë lëndët rrezikimi i sigurisë së komunikacionit kun ë vitin 2015 kemi gjithsej 24 aktgjykime të plotëfuqishme, në vitin 2016 kemi 16 aktgjykime, në vitin 2017 numër më të madhë të aktgjykimeve, dhe në vitin 2018 gjithsej 16 aktgjykime kanë marrë formë të prerë. Pastaj vin veprat kërcënim me mjetë të rrezikshëm gjatë rrahjeve kun ë vitin 2015 janë gjithsej 20 aktgjykime të plotfuqishme, në vitin 2016 janë 15 aktgjykime, në vitin 2017 vetëm 6 aktgjykime ,dhe në vitin 2018 janë 11 aktgjykime të forms së prerë. Pastaj vine veprat të rënda kundër sigurisë së përgjithshme shoqërore kun ë vitin 2015 janë evidentuar gjithsej 15 aktgjykime të plotfuqishme, në vitin 2016 gjithsej 11 aktgjykime të plotfuqishme, në vitin 2017 gjithsej 8 aktgjykime të plotëfuqishme ,dhe në vitin 2018 gjithsej 18 aktgjykime të plotëfuqishme . Pastaj kemi veprat kundër sigurisë së njeriut dhe pasurisë në komunikacion ku janë të evidentuara në vitin 2015 vetëm 7 aktgjykime të plotëfuqishme, në vitin 2017 janë evidentuar 7, në vitin 2017 vetëm 4, dhe 2018 vetëm 5 aktgjykime të plotfuqishme. Te veprat Vjedhje grabitqare në vitin 2015 kemi gjithsej 5 aktgjykime, në vitin 2016 kemi 5 aktgjykime , në vitin 2017 kemi gjithsej 2 aktgjykime të plotëfuqishme dhe në vitin 2018 kemi gjithsej 7 aktgjykime të plotëfuqishme. Te veprat penale privim i kundërligjshëm i lirisë në vitin 2015 janë evidentuar 7 aktgjykime të plotëfuqishme, në vitin 2017 vetëm 7 aktgjykime , në vitin 2017 dhe 2018 vetëm nga 1 aktgjykim. Dhe në fund janë renditur veprat penale sulm seksual mbi të miturit edhe ate në vitin 2015 vetëm 4 aktgjykime janë evidentuar, në vitin 2016 janë evidentuar vetëm 3 aktgjykime, dhe në vitin 2017 nuk ka të evidentuar asnjë aktgjykim, në vitin 2018 janë evidentuar 3 aktgjykime të plotëfuqishme edhe ate bëhet fjalë më shumë për ato aktgjykime ku gjykata ose ka vendosur për kërkesën pasuroro juridike ose e ka udhëzuar palën që kompenzimin e dëmit ta realizoj në kontest civil.

Mirpo duhet të kemi parasysh se këto të dhëna janë marrë nga sistemi akmis gjykatës , por duke patur parasyh se ka edhe raste tjera kur gjykata vendos për kërkesën pasuroro juridike ose kur palën e udhëzon në kontest e që nuk janë të paraqitura në këto statistika , pra duhet të kemi parasyshë se ky numër nuk është edhe aq i saktë lidhur me atë se sa gjykata vendos për kërkesën pasuror juridike të palëve për kompenzimin e dëmit material, sepse vetë program Akmis i gjykatës nuk e bën dallimin lidhur me regjistrimin e lëndëve kur parashtrohet kërkesë pasuroro juridike apo nuk parashtrohet kërkesa e tillë , në mënyrë që të kemi të dhëna më të sakta.

2. RASTET NGA PRAKTIKA GJYQËSORE KU ËSHTË VENDOSUR PËR KOMPENZIMIN E DËMIT MATERIAL NË GJYKATËN SHKUPI 1 SHKUP NGA VITI 2015 E KËNDEJ

Objekti i analizës janë aktgjykimet e gjykatës themelore Shkupi 1 Shkup, aspekti i veprimit praktik në Gjykatë. Qëllimi është që përmes pasqyrës analitike të shohim se si zbatohet Ligji në praktik në rastin e caktimit të dëmit material apo kur vendoset për kërkesën pasuroro juridike të palëve.

2.1. Rasti i pare –Aktgjykimi i shpalluar në vitin 2016

P.nr.....

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP – si gjykatë e shkallës së parë, përmes gjykatësit S.R si gjykatës i vetëm, me procesverbalist M.B - punëtor gjykate, duke vepruar sipas propozim akuzës së PTHP Shkup Ap2 nr..... më dt....., kundër të akuzuarit L.S nga Sh për vepër penale – vjedhje të energjisë elektrike dhe energjisëngrohëse ose të gazit natyror të nenit 235-a paragrafi 1 të KP, pas mbajtjes së seancës kryesore, verbale dhe të hapur, në prani të Prokurorit publik të PTHP Sh., J.Sh.dhe të akuzuarit në pajtim me nenin 381 nga Ligji i procedurës penale, më dt.06.12.2016, e solli dhe publikisht e shpalli këtë:

AKGJYKIM

në bazë të pranimit të fajësisë

I AKUZUARI

L.S., me NUAQ, nga babai M., nëna M., i lindur më dt. në Sh., ku jeton në rr. ,,“ Sh., me nr. të letërnjoftimit..., i pamartuar, me arsim të mesëm, i punësuar në firm private, me të ardhura mujore prej 15000,00 denarësh, Maqedon, shtetas i RM-së, i dënuar për vepër penale nga neni 297 paragrafi 1 të KP , ndaj tij nuk zhvillohet procedur tjetër penale.

ËSHTE FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Në periudhën kohore prej datës 07.05.2014 deri më dt. 13.05.2014 me qëllim që për vete të përfitoj në mënyrë të kundërligjshme në objektin e tij të kafeterisë“.....” SHPKNJP..... Sh., të lokalizuar në rrugën, nga i dëmtuari Elektroekonomia e Maqedonisë SH.A Sh., ka marrur dhe ka përvetsuar në mënyrë të kundërligjshme energji elektrike në shumë prej 2.173,50 kv/orë në shumë prej 21.577,00 denarësh duke bërë zhvendosjen e orëmatësit, kështu që orëmatësi elektrik nuk ka regjistruar energjin elektrike të harxhuar në fazën e parë, me në cilën shumë e ka dëmtuar të dëmtuarin EVN Maqedoni SHA.

Me këtë veprim i akuzuari ka kryer vepër penale vjedhje të energjisë elektrike, energjisëngrohëse ose të gazit natyror të nenit 235-a paragrafi 1 të Kodit Penal, ndërsa në pajtim me këto nene dhe nenet si 4,32,33,34,35,39,40,41,48, 48-a, 50 të KP, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar masë alternative:

DËNIM ME KUSHT

Dënim i caktuar me burgim prej 3 muajsh, e cila nuk do të ekzekutohet përderisa i akuzuari në afat prej 1 viti pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë nuk kryen vepër tjetër penale dhe i CAKTON:

Dënim me të holla në shumë prej 20.000,00 denarësh si dënim ndihmës të cilin dënim duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, dhe nëse të njëjtën nuk e paguan në afatin e caktuar ose nëse dënimi me të holla nuk ekzekutohet nën kanosje, gjykata do të ekzekutoj ashtu për çdo 20 euro në llogari denarësh do të caktoj një ditë burg, dhe më këtë burgimi nuk mund ygjatë më shumë se 6 muaj.

Në pajtim me nenin 105 paragrafi 1 të LPP OBLIGOHEM i akuzuari të kompenzoj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 9.500,00 denarësh nga e cila shumë prej 2.000,00 denarësh në emër të paushallit gjyqësor neni 102 paragrafi 2 pika 6 të LPP, shumën prej

2.000,00 denarësh në emër të përfaqësuesit të të akuzuarit S.L . B avokat nga Sh., i caktuar sipas detyrës zyrtare në procedurën gjyqësore për lëndën P.nr. ..., ndërsa në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 7 të LPP dhe shumën prej 5.500,00 denarësh në emër të pregaditjes së ekspertizës nga ekspertit M.B në lëndën e kësaj procedure të regjistruar me nr. P.nr..., ndërsa në pajtim me nenin 102. paragrafi 2 pika 1 të LPP, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prer nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 114 paragrafi 2 të LPP obligohet i akuzuari L.S që të dëmtuarit EVN Maqedoni SHA, të paguaj shumën prej 21.577,00 denarësh, shumë të cilën i akuzuari do ta kompenzoj në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën të prerë,nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 455 paragrafi 2 të LPP, aktgjykimi i Gjykatës themelore Shkup XXVIII. P.nr.... më dt. 05.05.2016, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m i

PTHP Sh., deri te kjo gjykatë ka parashtuar propozim akuz Ap.nr.... me dt. 25.11.2015 kundër të akuzuarit L.S nga Sh., për vepër penale Vjedhje të energjisë elektrike, energjisë ngrohëse ose gazit natyror të nenit 235-a paragrafi 1 të KP.

Me aktgjykim të Gjykatës Themelore Shkup XXVIII.P.nr... me dt.05.05.2016, në pajtim me nenin 365 paragrafi 3 I LPP, i akuzuari L.S është shpallur fajtor dhëështë dënuar me burgim prej 2 vite dhe dënim me të holla në shumë prej 20.000,00 denarësh, të cilën duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën të prerë,nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm, gjykatat do ta ekzekutoj ashtu që për cdo 1.000,00 denar do të caktoj një ditë burg, dhe më këtë burgimi nuk mund të jet më i gjat se 6 muajsh, ndërsa njëkohësisht i akuzuari obligohet që ta kompenzoj dëmin në shume prej 21.577,00 denarësh, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prer nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm, si dhe ti kompenzoj harxhimet e procedurës në shumë prej 9.500,00 denarësh, nga e cila 2.000,00 denarësh në emër të paushallit gjyqsor në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 6 të LPP, shumë prej 2.000,00 denarësh në emër të përfaqësuesit mbrojtës të akuzuarit, S.L.B avokat nga Sh., i caktuar

sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 7 të LPP dhe shumë prej 5.500,00 denarësh në emër të ekspertizës së kryer nga eksperti M.B në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 1 të LPP, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh pasi akgjykimi të marrë formë të prerë nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në bazë të kërkesës për përsëritje të procedurës penale me dt.16.09.2016, nga i akuzuari përmes BurgutSh., gjykata solli vendim, KPOV.nr.... me dt. 16.09.2016, me të cilën lejohet përsëritje e procedurës ndaj të akuzuarit L.S., nga Sh., për veprë penale Vjedhje të energjisë elektrike, energjisë ngrohëse dhe gazit natyror në pajtim me nenin 235-a paragrafi 1 të LPP dhe i janë caktuar masa të kujdesit paraprak me të cilat obligolet i akuzuari L.S nga Sh., çdo të Hënë deri në ora 12,00 që nga momenti kur vendimi të marrë formë të prerë të paraqitet në gjykatë te personi zyrtar kompetent në sportelin nr.7, e cila masë duhet të zgjatë deri në plotfuqishmërin e procedurës penale ose deri në ndonjë vendim tjetër të sjellur nga ana e gjykatës, si dhe nëse i akuzuari nuk i përmbahet masave të kujdesit paraprak, ndaj të nejtut do të shqiptohet masë paraburgimi. Vendimi është i plotfuqishëm më dt.18.10.2016.

Në pajtim me veprimet e lartpërmendurat, duke u bazuar në propozim akuzën gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtim kryesore më dt..... dhe në të njëjtën përfaqësusi i aktakuzës e paraqiti përmbajtjen e aktakuzës,ndërsa i akuzuari ishte i thirrur që të deklarohet se a ndjehet fajtor në pajtim me nenin 380 pika të LPP. I akuzuari L.S., deklaroi se është fajtor për veprë penale e cila i është ngarkuar me propozim akuz,dhe në vazhdim theksoi se është e vërtet që veprën e ka kryer në kohë, vend dhe mënyrën siç është e përshkruar në propozim akuz nga PTHP Sh..

Gjykata,në shqyrtimin kryesore në pajtim me nenin 381 paragrafi 2 të LPP, pasi vërtetoi se pranimi i fajësis nga i akuzuari është dhënë vullnetarisht, dhe se i njëjti është njohur për pasojat juridike të lidhura me të drejtën pronore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 381 paragrafi 3 të LPP ka nxjerrur faktet të cilat i referohen vendimit të sanksionit penal dhe kërkesës pasuroro juridike, gjykata bëri shikimin dhe leximin, e vërtetimit të dhënë nga kjo gjykatë të evidentuar si KE nr....., të dt. 22.10.2015 nga e cila vërtetohet se i akuzuari nuk është dënua.

Në fjalën përfundimtare Prokurori publik, theksoi se tërësisht qëndron pas propozim akuzën ndaj të akuzuarit L.S për vepër penale – Vjedhje të energjisë elektrike, energjisë ngrohëse ose gazit natyror në pajtim me nenin 235-a paragrafi 1 të KP, dhe ka theksuar se duke u bazuar në faktet të cilat i posedon prokurori në korelacion më pranimit e fajit nga i akuzuari se e ka kryer veprën penale, është vërtetuar mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, dhe i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

I autorizuari i personit juridik të dëmtuar E.M. SHA, prej SH., në fjalën përfundimtare ka thënë se paraqet kërkesën pasuroro juridike në shumë prej 21.577,00 denar, dhe se i bashkangjitet hetimit penal.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka thënë se pendohet për veprën e kryerë, shpreh keqardhje për ngjarjen e ndodhur, dhe premtun se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale ose të ngjajshme.

Gjatë caktimit dhe matjesë së lartësisë së dënimit , gjykata kishte parasysh të gjitha rrethanat të nenit 39 të KP, dhe kështu si rrethana rënduese ka patur parasysh llojin, karakterin dhe peshën e veprës penale, shpeshmërin e kryerjes së kësaj veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i akuzuari kishte pranuar fajësin, faktin se i akuzuar më parë nuk ka qenë i dënuar, dhe se ndaj tij nuk procedohet për vepër tjetër penale, njëkohësisht gjykata kishte marrë parasysh edhe mundësit personale, materiale, dhe familjare të të akuzuarit, moshën e të akuzuarit se është i lindur më, që nënkupton se është relativisht në moshë të re, , kështu gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me kusht me të cilën i caktoi dënim me burgim prej prej 3 muajve, ku i njehti nuk do të ekzekutohet përderisa i akuzuari në afat prej 1 viti pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë nuk kryen vepër tjetër penale dhe i caktoi gjobë në shumën prej 20.000,00 denarësh, të cilën duhet ta paguaj në afat prej 15 dite pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, dhe se nëse të njejtën gjobë nuk do ta paguaj në afatin e caktuar apo nëse gjoba nuk është ekzekutuar me dhunë, gjykata do ta përmbaroj ashtu që për çdo 20 euro në kundërvlerë të denarëve do të caktoj një dit burgim, me çrast burgimi nuk mund të zgjatë më shumë se 6 muaj, duke shpresuar se me shqiptimin e dënimit të këtill do të arrihen qëllimet e dënimit, në kuptim të parandalimit special dhe atij general, sipas nenit 32 të KP.

Në pajtim me nenin 105 paragrafi 1 të KP , ka obliguar të akuzuarin ti kompenzoj shpenyimet e procedurës penale në shumë prej 9.500,00 denar, prej së cilës shumë 2.000,00 denarë në emër të paushallit gjyqësorë në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 6 të LPP, shumën prej 2.000,00 denarë në emër të përfaqësuesit të të akuzuarit S.L.B. avokat nga SH., I caktuar sipas detyrës zyrtarë në procedurë për lëndën penale P.nr....., ndërsa në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 7 të LPP dhe shumën prej 5.500,00 denar, në emër të ekspertizës të kryerë nga eksperti M.B.për lëndën e kësaj procedure P.nr....., dhe në pajtim me nenin 102 paragrafi 2 pika 7 të LPP, e gjithë kjo në afat prej 15 dite pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm

Gjykata në pajtim me nenin 114 paragrafi 2 të LPP obligoi të akuzuarin L.S që të dëmtuarit EVN Maqedoni SHA, ti paguaj shumën prej 21.577,00 denarësh, shumë të cilën i akuzuari do ta kompenzoj në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën të prerë, nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 455 paragrafi 3 të LPP, gjykata aktgjykimin e Gjykatës themelore Shkup , P.nr..../16, P.nr...../15 të dt...., e shfuqizoi.

GJYKATA SHKUPI 1 SHKUP

P.nr... të dt 06.12.2016,

Procesverbaliste

M.B.

Gjykatës

S.R.

2.1.1. Analiza e rastit të pare nga praktika gjyqësore

Në praktikën gjyqësore rastet më të shpeshta të veprave penale janë ato drejtuar kundër pasurisë dhe njeriut. Te këto vepra penale hynë edhe vjedhja e sidomos raste më të shpeshta nga praktika kemi rastet e vjedhjes së rrymës elektrike.

Prandaj Vjedhja konsiderohet si marrje e pasurisë së huaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj për vete apo për personin tjetër. Gjykata në rastin konkret ka vendosur të dënoj të akuzuaritpërshtak se në periudhën kohore prej datës 7.05.2014 deri më dt. 13.05.2014 me qëllim që për vete të përfitoj në mënyrë të kundërligjshme në objektin e tij të kafeterisë“.....”SHPKNJP... Sh., të lokalizuar në rrugën, nga i dëmtuari Elektroekonomia e Maqedonisë SH.A Sh., ka marrur dhe ka përvetsuar në mënyrë të kundërligjshme energji elektrike në shumë prej 2.173,50 kv/orë në shumë prej 21.577,00 denarësh duke bërë zhvendosjen e orëmatësit, kështu që orëmatësi elektrik nuk ka regjistruar energjin elektrike të harxhuar në fazën e parë, me në cilën shumë e ka dëmtuar të dëmtuarin EVN Maqedoni SHA.

Gjykata ka konstatuar se i akuzuri në rastin konkret ka kryerë veprë penale të Vjedhjes–vjedhje të energjisë elektrike dhe energjisëngrohëse ose të gazit natyror të nenit 235-a paragrafi 1 të Kodit penal.Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar masë alternative dënim me kushtë-Dënim i caktuar me burgim prej 3 muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet përderisa i akuzuari në afat prej 1 viti pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë nuk kryen veprë tjetër penale duke i caktuar dënim me të holla në shumë prej 20.000,00 denarësh si dënim ndihmës të cilin dënim duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë.

Ndërsa lidhur me kërkesën pasuroro juridike të pales gjykata ka vendosur në pajtim me nenin 114 paragrafi 2 të LPP me çrast ka obliguar të akuzuarin L.S që të dëmtuarit EVN Maqedoni SHA, ti paguaj shumën prej 21.577,00 denarësh, shumë të cilën i akuzuari do ta kompenzoj në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën të prerë,nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Pra në rastin konkret vepra penale është kryerë nga personi fizik ndaj personit juridik. Gjykat gjatë shqiptimit të dënimit kishte marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të pales së akuzuar si dhe të gjitha provat e tjera materiale.

2.2. Rasti i dytë- Aktigjykim i shpallur në vitin 2017

XX P.nr....

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP, si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit V.P.T. si gjykatës i vetëm, me procesverbalist M.M-punëtor gjykate, duke vepruar sipas propozim akuzës së PTHP-SH., Ap.2 nr...., të dt....., kundër të akuzuarit M.P., nga SH...për vepër penale - Vjedhje nga neni 235 paragrafi 1 nga Kodi penal, pas mbajtjes së seancës kryesore, verbale dhe të hapur, të dt..... në prezencë të Prokurorit publik të PTHP Shkup-J.P., të akuzuarit M.P., e solli dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I A K U Z U A R I

M.P. Me NUAQ....., nga babai...., nëna...., i lindur më....., në SH., ku edhe jeton në f.G....rr....., nr....., Maqedon, shtetësia e Maqedonisë, i ndarë, i papunësuar, i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohen procedura për vepra tjera penale.

Ë S H T Ë I F A J S H Ë M

PËR SHKAK SE:

Në dt....., rreth orës 18,20, në bul.K.P.M., në afërsi tëT., në SH., nga vetura e tipit AT "Opel Vektra", me targa nacionale..kosovare, .ka marrë një telefon të llojit " Ajfon 5" dhe një telefon " Ajfon 4", në shumën prej 15.000,00 denar ose në shumën e plotë prej 30.000,00 denar, pronësi e të dëmtuarit B.F., me qëllim e përvetësimit për vete, në mënryn që pasi ishte ofruar pranë veturës, nga dera e pambyllur e automjetiti ka hyrë brenda dhe nga fioka ka marrë telefonat dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

Me veprimet e lartëpërmendura i akuzuari M.P. nga SH., ka kryerë veprën penale - Vjedhje të nenit 265 paragrafi 1 të Kodit penal, dhe në pajtim me nenet e theksuara dhe nenet 3,

4, 7, 29,30, 31, 32, 33, 39 të Kodit penal, dhe nenit 102 dhe 105 të Ligjit për procedurë penale, dhe nenit 6, 7, të Rregullorës për mënyrën e matjes së dënimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonise, gjykata të akuzuarit e::

DËNON ME DËNIM ME BURGIM PREJ 1 viti e gjashtë muaj

Në pajtim me nenin 102 dhe nenin 105 , OBLIGOHEM i akuzuari M.P. të paguaj shumën prej 2.000,00 denarësh, në emër të paushalit gjyqësor, në xhirollogarin nr 100000000063095, llogari të shfrytëzuesit buxhetorë 2901000973, njësia 631, shfrytëzues 10, shifra 724 132, programa 20, mënyra 2, pranues Gjykata themelore Shkupi 1 Shkup, deponent BPRM, të gjitha në afat prej 15 ditëve pasi aktgjykimi të marrë formë e prerë , ndërsa nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 114 të Ligjit për procedurë penale OBLIGOHEM i akuzuari M.P. të kompenzojë dëmin të dëmtuarit B.F. të parashtruar me kërkesën pasuroro juridike në shumën prej 30.000,00 denarë, në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, ndërsa nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

A R S Y E T I M

PTHP SH., deri te kjo gjykatë parashtroi propozim akuzën AP.2nr..., të dt....., kundër të akuzuarit M.P. nga SH...., për veprën penale-Vjedhje të nenint 235 paragrafi 1 të Kodit penal. Gjykata duke proceduar sipas propozim akuzës, mbajti shqyrtim kryesor, verbal dhe të hapur më dt. 02.12.2016 në praninë e prokurorit publik të PTHP SH.... JS., dhe . të akuzurit.

I autorizuari i aktakuzës, ka lexuar përmbajtjen e propozim akuzës, ndërsa në fjalën përfundimtare, ka qëndruar plotësisht pas propozim akuzës së paraqitur, sepse nga të gjitha provat materiale dhe verbale gjatë procedimit, padyshim jashtë cdo mendimi të drejtë del se i akuzuari ka kryerë veprën penale .

Megjithatë, gjatë periudhës kohore në të cilën është kryer vepra penale, i akuzuari ka

shfrytëzuar sim kartelën nr...., kjo sim kartel është e operatorit mobil V. dhe pas kërkimit dhe marrjes së listës nga V., numri thirrës ka qenë i personit D.P. Ky numër thirrës ka qenë shfrytëzuar në aparatit telefonik Imei, i marrë nga vetura e të dëmtuarit. Për këto arsye mbrojtja e tillë nuk ka bazë, i propozoi gjykatës të akuzuarit ti shqipton sanksion penal duke i patur parasysh të gjitha rrethanat e parapara në nenin 39 të Kodit penal, si dhe rregulloren për mënyrën e matjes së dënimit, e cila masë edukative do të ndikoj që i akuzuari në të ardhmen mos të kryejë vepra të njejta penale.

I akuzuari M.P. në fjalën përfundimtare ka thënë se telefon të tillë nuk ka marrë, dhe se nuk e di se si numri i tij i telefonit është gjindur në telefonin mobil të të dëmtuarit.

Gjatë mbajtjes së shqyrtimit kryesorë, pasi që i akuzuari ishte shpjeguar se nuk ndjehet fajtor, në kuadër të procedurës së provave gjykata e ka dëgjyuar të dëmtuarin B.F. dhe në vazhdimin e procedurës ka lexuar listën e detalizuar të thirrësve të O.V. SHPK., SH., dhe certifikatën e evidencës ndëshkimore, dhe duke i vlerësuar të gjitha provat secilën vecmas dhe lidhur me provat e tjera, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në vijim:

M.P. , nga babai...., i lindur më....., në SH., ku edhe jeton, Maqedon, shtetësia e Maqedonisë, i ndarë, i papunësuar, i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohen procedura për vepra tjera penale.

Në dt....., rreth orës 18,20, në bul.K.P.M., në afërsi tëA.T., në SH., nga vetura e tipit AT "Opel Vektra", so K.me targa nacionale.....ka marrë një telefon të llojit " Ajfon 5" dhe një telefon " Ajfon 4", në shumën prej 15.000,00 denar ose në shumën e plotë prej 30.000,00 denar, pronësi e të dëmtuarit B.F., me qëllim të përvetësimit për vete , në mënyrën që pasi ishte ofruar pranë veturës, nga dera e pambyllur e automjetit ka hyrë brenda dhe nga fioka ka marrë telefonat dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

Gjendjen faktike të tillë gjykata e vërtetoi nga provat e nxjerra verbale dhe materiale, nga të cilat u vërtetuan rrethanat relevante nën të cilat është kryer, koha, vendi, mënyra dhe pasojat nga e njejta. Nga deklarata e të dëmtuarit B.F., gjykata vërtetoi se ditën kritike ka qenë i parkuar me AM. "Opel Vektra", me targa të kosovës, në afërsi të A.T. në SH. Më pas vetura nuk ishte e

mbyllur dhe se kur ishte ofruar afër saj pas një kohe kishte vërejtur se mungonin te 2 telefonat të tipit Ajfon 5 dhe 4 në shumën prej 15.000,00 ose në shumën e plotë apo totale 30.000,00 denarë. Ngjarjen e kishte paraqitur në stacionin policor B.P. i kishte paraqitur edhe imei numrat e telefonave, ku pas një kohe njëri nga telefonët ishte aktivizuar, për të cilën e kishtë lajmëruar policin.. Ka thënë se të akuzuarin nuk e njeh, ka paralajmëruar kërkesën për kompenzim të dëmit, ndërsa gjykatës i le të vendosë për ndjekjen proceduralo penale.

Gjykata, ka pranuar tërësisht deklaratën e të dëmtuarit B.F., duke e vlerësuar si të qartë, detalë, dhe kategorik, dhe i njejtë korrespondon me listën e thirësve nga O.V. SHPK., SH. Prej të cilave gjykata ka vërtetuar se më dt.18.08.2015 ishte bërë thirrje nga numri/imei.... deri te numri/imei... me të dhëna se ka thirr M.P. SH..

Nga certifikata për evidencë ndëshkuese në emër të të akuzuarit M.P., të dt....., gjykata vërtetoi se i njejtë ka qenë i dënuar.

Në bazë të gjendjes së këtillë të vërtetuar, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit M.P.përmbahen të gjitha elementet e veprës penale -Vjedhje të nenit 235 paragrafi 1 të kodit Penal. Veprën penale të cituar më lartë është paraparë se " Ai i cili për vetë dotë marrë send të lëvizshëm me qëllim e përvetsimit të kundërligjshëm si në rastin konkret i akuzuari më dt.13.05.2015, rreth orës 18,20, në bul.K.P.M., në afërsi tëA.T., në SH., nga vetura e tipit AT "Opel Vektra", me targa nacionale K...ka marrë një telefon të llojit " Ajfon 5" dhe një telefon " Ajfon 4", në shumën prej 15.000,00 denar ose në shumën e plotë prej 30.000,00 denar, pronësi e të dëmtuarit B.F., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në mënyrën që pasi ishte ofruar pranë veturës, nga dera e pambyllur e automjetit ka hyrë brenda dhe nga fioka ka marrë telefonat dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, me të cilin veprim i akuzuari ka përmbushur të gjitha elementet e qenies juridike që i vihet në barrë, për të cilën gjykata e shpalli fajtor dhe dënoi në pajtim me ligjin.

Gjykata e vlerësoj deklaratën e të akuzuarit se ai nuk është fajtor për shaktimin e veprës penale, dhe se të njejtën nuk e ka kryer dhe nuk ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, mirpo deklaratën e tillë gjykata nuk e pranoi sepse deklarata e tij ishte në kundërshtim me provat e nxjeruor gjatë shqyrtimit kryesorë, të propozuara nga ana e paditësit , dhe mbrojtën e tij nuk e

kishte mbështetur në asnjë provë.

Gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat të parapara në nenin 39 të Kodit penal, rregulloren për mënyrën e matjes së dënimit të Gjykatës Supreme të RM, . Si rrethana rënduese gjykata kishte marrë parasysh kryerjen e shpeshtë të veprës penale, faktin se i akuzuari është dënuar më parë, si dhe faktin se i dëmtuari ka paraqitur kërkesën pasuroro juridike. Si rrethana lehtësuese, gjykata e vlerësoi faktin se i akuzuari është i ri, sjelljen e tij të hijëshme gjatë procedurë penale, arsyen se nuk është i punësuar, dhe i ndarë. ,

Duke i vlerësuar të gjitha kërto rrethana, në pajtim me Rregulloren për mënyrën e matjes së dënimit, ka bërë rikualifikimin e veprës penale e cila i vihet në barrë, dhe kështu për veprën penale Vjedhje të nenit 235 të Kodit penal, të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit ku sipas kategorizimit objektiv vepra penale bie në kategorin e 12 horizontale, dhe sipas të dhënave të mëparshme nga jeta e kryerësit , lënda bie në kolonën e dytë vertikale në të cilin është paraparë dënimi me burgim prej 9 muaj deri në 2 vjet, ku shuma për një vit e 4 muaj, ku pas ndryshimit evalual kryesojnë rrethanat rënduese, e ka shpallur fajtor dhe dënuar me burgim prej 1 viti e 6 muaj, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, të paraparë me nenin 32 të Kodit penal, në këndvështrimin e speciales ashtu edhe në këndvështrimin e preventivës gjenerale, dhe të ndikohet pozitivisht ndaj të akuzuarit që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla penale.

Në pajtim me nenin 102 dhe 105 të Ligjit për procedurë penale, Obligohet i akuzuari M.P. të paguaj paushall gjyqësorë në shumën prej 2.000,00 denarë, në xhirollogari nr. 100000000063095, llogaria të shfrytëzuesit buxhetorë 2901000973, njësia 631, shfrytëzues 10, shifra e të hyrave 724132, programa 20, mënyra 2, pranues Gjykata themelore Shkupi 1 Shkup, deponent BPRM, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së vendimit, ndërsa nën frikën e përmbarimit të dhunshëm.

Në pajtim me nenin 114 të Ligjit për procedurë penale, OBLIGOHET i akuzuari M.P. ti kompenzoj të dëmtuarit B.F. Kërkesën e paraqitur pasuroro juridike në shumën prej 30.000,00 denarë, në afat prej 15 dite prej ditës kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë, ndërsa nën frikën e

përmbarimit të dhunshëm.

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP

XXII P.nr..... të dt.....

Procesverbalist Gjykatës

M.M.V.P.

UDHËZIM: Kundër aktgjykimit lejohet ankesë në afat prej 8 ditë nga pranimi, përmes kësaj gjykate deri te gjykata e Apelit Shkup.

2.2.1. Analiza e rastit të dytë nga praktika gjyqësore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale të vjedhjes, ku gjykata të akuzuarin B.F. e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me denim me burgim prej 1 viti e gjashtë muaj sepse më dt....., rreth orës 18,20, në bul.K.P.M., në afërsi tëT., në SH., nga vetura e tipit AT "Opel Vektra", me targa nacionale..kosovare, .ka marrë një telefon të llojit " Ajfon 5" dhe një telefon " Ajfon 4", në shumën prej 15.000,00 denar ose në shumën e plotë prej 30.000,00 denar, pronësi e të dëmtuarit B.F., me qëllim e përvetësimit për vete, në mënën që pasi ishte ofruar pranë veturës, nga dera e pambyllur e automjetiti ka hyrë brenda dhe nga fioka ka marrë telefonat dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

Pra gjykata ka vlerësuar se në veprimet e lartëpërmendura i akuzuari M.P. nga SH., ka kryerë veprën penale -Vjedhje të nenit 265 paragrafi 1 të Kodit penal. Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga provat e nxjerra verbale dhe materiale, nga të cilat u vërtetuan rrethanat relevante nën të cilat është kryer, koha, vendi, mënyra dhe duke patur parasysh rrethanata lehtësuese si sjelljen e tij të hijëshmë gjatë procedurë penale, arsyen se nuk është i punësuar, dhe i ndarë ndërsa si rrethana rënduese kishte marrë parasë shpeshmërin e kryerjes së kësaj vepre penale nga na e të akuzuarit.

Pastaj në bazë të nenin 114 të Ligjit për procedurë penale, kishte obliguar të akuzuarin M.P. ti kompenzoj të dëmtuarit B.F. kërkesën e paraqitur pasuroro juridike në shumën prej 30.000,00 denarë, në afat prej 15 dite prej ditës kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë, ndërsa nën frikën e përmbarimit të dhunshëm. Në rastin konkret kemi të bëjmë me përvetsimin e

kundërligjshëm të pasurisë për vete nga ana e të akuzuarit edhe atë të telofanave mobil. Veprat e tilla janë të shpeshta në praktikë sikur që edhe së paku një herë i ka ndodhur ndonjërit një situatë e tillë vjedhjes. Vepra e tillë kryhet me dashje.

2.3. Rasti i tretë –Aktgjykimi i shpalluar në vitin 2018

P.nr.....

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP – si gjykatë e shkallës së parë, përmes gjykatësit S.N si gjykatës i vetëm, me procesverbalist L.A-punëtor gjykate, duke vepruar sipas propozim akuzës së PTHP Shkup XVI A.p nr..... me dt....., kunder të akuzuarit A.ZH nga Sh për vepër penale – Vjedhje e rëndë të neni 236 paragrafi 1.m.1 të Kodi penal dhe e akuzuara J.B nga Sh., për vepër penale – Vjedhje e rëndë të neni 236 paragrafi 1.m.1 të Kodi penal, pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe verbale në prani të Prokurorit publik nga Prokuroria themelore Shkup L.R, të akuzuari A.ZH dhe J.B mbrojtësi i të akuzuarit A.ZH, avokat G.B nga Sh., avokat D.P nga Sh.,dhe i autoiruari i të dëmtuarit D.B SHPK SH., avokat E.D nga zyra e avokateve D,D,K nga Sh.,në bazë të nenit 381 të LPP, në dt.03.10.2019, e solli dhe publikisht e shpalli këtë:

AKGJYKIM

në bazë të pranimi të fajësisë

TË AKUZUARIT:

A.ZH me NUAQ....., nga babai....., nëna, i lindur më dt. në Shkup, jeton në rr. ,,“ Sh., maqedonë, qytetar i RM,me arsim të mesëm, i papunë,me gjendje pasurore të dobët, i dënuar, nuk procedohet për vepër tjetër penale.

J.B me NUAQ....., nga babai....., nëna, e lindur më dt. në Shkup, jeton në rr. ,,“ Sh., maqedonase, gjytetare e RM,me arsim të mesëm, e papunë, ,me gjendje pasurore të dobët, e pa dënuar, nuk procedohet për vepër tjetër penale.

JANË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Më dt. 05.09.2018, orë 13,00 në D. Në rr. .nr.... në bastore sportive M. Filialja nr....., pronësi e D.B SHPK, me qëllimin e përvetësimit të kundërligjshëm, kanë marrë në mënyrë të pasjellshme shumën prej 104.923,00 denar, në mënyrë që një ditë më herët më 04.09.2018 janë marrë veshëd he e akuzuara J.B me vetëdije i ka ndihmuar me vetë dhënien e premtimit para kohe se do ti ndihmoj për të hyrë dhe për të hapur kutin e sigurisë në filiale e cila hapet një herë në ditë e cila është me kod të cilën e ka ditur ajo dhe me dhënjen e kodit duhet të pritët 10 minuta, më dt.05.09.2018, rreth orës 12,30 e kanë hapur kutinë e sigurisë dhe ka kryer veprimin numrimin e të hollave, pas së cilës i akuzuari A.ZH ka hyrë me bejzboll të zi, kapel dhe goje të mbyllur dhe me armë marka e panjohur pa thënë asnjë fjalë ka kthyer revolen në drejtim të të akuzuarës J.B, e cila në atë moment ja ka dorzuar të hollat të cilat ishin në kutin e sigurimit.

Me veprimet e lartpërmendura të akuzuarit A.ZH, ka kryer vepër penale Vjedhje e rëndë, të nenit 236 paragrafi 1 pika 3 të KP, ndërsa e akuzuara J.B ka kryer vepër penale Vjedhje e rëndë të nenit 236 paragrafi 1 pika 3 të KP në lidhje me nenin 24 të KP.

Në pajzim me nenet e lartpërmendura dhe nenet 4,32,33,34,35, dhe 39, të KP, të AKUZUARI A.ZH, për vepër penale Vjedhje e rëndë të nenit 236 paragrafi 1 pika 3 i KP, e DËNON ME DËNIM ME BURGIM PREJ 1 – VITI, ku i llogaritet edhe koha e kaluar e paraburgimit në Burgun e Shkupit, nga dt. 08.09.2018.

OBLIGOHET i akuzuari A.Zh, në bazë të nenit 114 të LPP, bashkërisht me të akuzuarën J.B, të paguajn për të dëmtuarin dëmshpërblimin e kërkuar juridik të dëmtuarit D.B. SHPK, SH., shumën prej 104.923,00 denarësh, në afat prej 3 muajve, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kanosje të ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenet e lartpërmendura , si dhe nenet 4,32,33,39,48-a,49 dhe 50 të KP, gjykata të akuzuarës J.B për vepër penale Vjedhje e rëndë të nenit 236. paragrafi 1 pika 3 në lidhje me nenin 24 të KP, njëkohësisht i shqipton mas alternative:

DËNIM ME KUSHT

Dënim i caktuar me kusht prej 2 vite, në të cilën lloaritet dhe koha e kaluar në burg shtëpiak nga dt.08.09.2018, dhe nuk do të ekzekutohet, përderisa i akuzuari, në afat prej 5-Vitesh, nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale.

OBLIGOHET, e akuzuara J.B. në pajtim me nenin 114 të LPP, bashkarisht me të akuzuarin A.ZH të pagujn të dëmtuarit D.B SHPK Sh., dëmshpërblimin e kërkuar juridik, shumë prej 104.923,00 denarësh, e gjith kjo brenda 3 muajve, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kanosje të ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me n. 49 pr. 2 të KP, dënimin e caktuar me burgim të shqiptuar në dënim me kusht do të ekzekutohet përderisa e akuzuara J.B të dëmtuarit D.B SHPK Sh., bashkarisht me të akuzuarin A.ZH nuk ja kompenzojnë kërkesën pronsore juridike në shumen 104.923,00 denarësh, në afat prej 3 muajve, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë .

I dëmtuari D.B SHPK Sh., në bazë të nenit 114 të LPP, për dallim nga kërkesa pasuroro juridike e gjykuar në shumë prej 104.923,00 denarësh, për kërkesën e parashtruar pasuroro juridike prej 196.270,00 denarësh, UDHËZOHET që ta realizojë në contest.

OBLIGOHEN të akuzuarit A.ZH dhe J.B, në pajtim me n. 102 dhe n. 105 pr. 1 të LPP, të paguaj gjykatës paushallin gjyqësor prej 2.000,00 denarësh, në llogari të gjykatës, si dhe ti kompenzoj harxhimet e shkaktuara të procedurës penale dhe atë të akuzuari A.ZH të paguaj shumë prej 3.233,00 denarësh, në harxhime transporti për sjelljen e të akuzuarin dhe përfaqësuesve zyrtar nga Burgu i Shkupit Sh., si dhe shumë prej 4.000,00 denarësh, në emër të dhuratës dhe dhuratave me rëndësitë avokatit mbrojtës të caktuar sipas detxres zyrtare, advokat G.K nga Sh., dhe e akuzuara J.B të paguj shumë prej 960,00 denarësh, në emër të shpenzimeve për transportim të personat zyrtar pas parashtrimi të listës për shpenzime nga MPB SP Gazibaba, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, ndërsa nën frigën e përmbarimit të dhunëshëm.

Arsyet i mi

PTHP Sh., deri te kjo gjykatë , ka paraqitur aktakuz A.p nr..... më dt.11.09.2018, kundër të akuzuarve A.ZH nga Sh. për veprë penale Vjedhje e rëndë të n.236 pr.1 p.3 të KP dhe J.B nga Sh., për veprë penale Vjedhje e rëndë të n.236 pr.1 p.3 lidhur me n.24 të LPP.

Gjykata, duke proceduar në bazë të propozim akuzës së PTHP Sh., më datë 21.09.2018, mbajti shqyrtim kryesor, publik dhe verbal, në prani të prokurorit publik, të akuzuarve A.ZH dhe J.B , ku u deklaruan për pranim të fajit mbi veprën e kryer penale me të cilën ngarkohet.

Autorizuesi i aktakuzës në fjalën përfundimtare bëri precizim të propozimkuzës sikur në të shqiptuarën e aktgjykimit, ndërsa pastaj theksoi se në aspektin e të drejtës penale edhe ndihma dhën me kryerjen e veprës penale paraqet vepër të rënd penale, me rrethana të shumta rënduse, ka shprehur se përmes zhvillimit të kësaj procedure të akuzuarit të cilet janë persona të rij më nuk do paraqiten si kryes të veprës penale, se për kryerjen e veprës penale duhet të jepet përgjegjësi dhe se pret nga gjykata që të marr një vendim të till me çrast të gjithë ata që do të dëgjojnë për një shqiptim të tillë , do të largohen nga mendimi i kryerjes së vepër penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.ZH, avokat G.K nga Sh., i caktruar sipas detyrës zyrtare në fjalën përfundimtare theksoi se caktimi i paraburgimin ndikon keq në sjelljen dhe në mënyrën e te menduarit të të akuzuarit, dhe duke pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësin mendon se me shqiptimin e një dënimi më të lehtë mundë të ndikoj në risocializimin e tij në institucione dhe jasht tyre. Gjithashtu ka theksuar se edhe nëna e tij kujdeset shumë për te dhe e njejta ka dhënë premtimin se pas përfundimit të këtij procesi, do të ndikoj në risocializimin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarës J.B avokat D.P nga Sh., në fjalën përfundimtare paraqet të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat janë në anën të akuzuarës, para së gjithash pranimin e fajit dhe kontributin e dhënë për përfundimin efektiv të procedurës penale. Më pastaj, thirret në faktin se e njejta është e re, që ka vite, dhe është i bindur se më nuk do të jet kryes i veprës penale. Mbrojtësi gjithashtu theksoi se e njejta jeton në një familje jofunksionale, ku prindërit e saj jan pran ndarjes dhe kërkohei nga gjykata që të ketë parasyshë gjendjen e saj emocionale. Duke pasur parasyshë të thënat e lartëpërmendura, kërkohet nga gjykata që të zbatoj masa alternative, me të cilat do të arrihet qëllimi i dënimit, dhe ta përpjestoj peshën e veprës në funksion të preventivës gjenerale dhe speciale.

I akuzuari A.ZH në fjalën përfundimtare theksoi se me të vërtet pendohet për kryerjen e veprës penale, se shumë ka gabuar dhe betohet se në të ardhmen nuk do të paraqitet si kryes i ketyre veprave penale dhe vepra tjera penale.

E akuzuara J.B në fjalën përfundimtare theksoi se pendohet për veprën, ndjen fajësi dhe se në të ardhmen nuk do të paraqitet si kryes i veprave penale te njejta dhe tjera.

Pasi që gjykata, në pajtim të nenit 381 paragrafi 2 i KP, ka vërtetuar se pranimi i fajit i të akuzuarve është dhënë vullnetarisht, dhe të njejtën e japin, pa ndikimin e askujt, pa u sjedhur në

lajthim apo nën kërcënim të sjellur në mashtrim ose kërcënim, gjithashtu janë të vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të fajit, për pasojat e të drejtës pronësore juridike për të kompenzuar harxhimet e procedurës penale, ka marrë parasyshë vetëm provat e nxjerrura që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit penal.

Gjatë procedimit të provave, gjykata ka lejuar vërtetimin e evidencës ndëshkimore Ap.- me dt. 07.09.2018 në emër të akuzuarit A.ZH., dhe pranimin e fajit në shqyrtimin kryesor, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në vijim:

I akuzuari A.ZH është person i ri, i lindur me vitin, i njejti është i arsimuar me arsim të mesëm, i papunë, pa pronësi, i gjykuar për vepra të njejta penale, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.

E akuzuara J.B është person i ri, e lindur me vitin, e njejta është e arsimuar me arsim të mesëm, e papunë, pa pronësi, e pa gjykuar, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Më dt.05.09.2018 rreth orës 13,00 në Sh., në rr. nr.në bastore sportive M. Filialja nr....., pronësi e D.B SHPK, me qëllimin e përvetësimit të kundërligjshëm, në mënyrë tinzarekanë marrë 104.923,00 denar, në mënyrë që një ditë më herët më 04.09.2018 janë marrë veshë dhe e akuzara J.B me vetëdije i ka ndihmuar me vetë dhënien e premtimit se do ti ndihmojë për të hyrë dhe për të hapur kutin e sigurisë në filiale e cila hapet një herë në ditë e cila është me kod të cilën e ka ditur ajo dhe me dhënjen e kodit duhet të pritët 10 minuta, më dt.05.09.2018, rreth orës 12,30 e ka hapur kutin e sigurisë dhe ka marrë veprimin numrimin e parave, pas së cilës i akuzuari A.ZH ka hyrë me bejzboll i zi, kapel dhe gojë të mbyllur dhe ka drejtuar armën mark e panjohur drejt të akuzuarës J.B, e cila në atë moment ja ka dorëzuar të hollat të cilat ishin në kutin e sigurimit.

Përfaqësuesi i autorizuar i personi juridik D.B SHPK Sh., avokat E.D nga Sh., paraqiti kërkesë pronësore juridike në shumën prej 196.270,00 denarësh, nga e cila shumë prej 104.923,00 si shumë për dëmin e shkaktuar material nga i akuzuari A.ZH., gjatë kryerjes së veprës penale dhe shumën prej 91.347,00 denarësh për dëmin e shkaktuar nga ana e të akuzuarës J.B, për veprimet e ndërmarra para kryerjes së veprës penale.

Gjendjen faktike si më sipër, gjykata e konfirmoi nga pranimi i tërsishëm i fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin kryesor, dhe për të cilën gjykata konstatoi se është dhënë vullnetarisht dhe në vetdije për pasojat juridike të saj, dhe duke e sjell të njëjtën në përputhshmëri me provat e nxjerrura dhe të propozuara nga prokurori publike, që ka të bëjë me vendimin mbi sanksionin penal edhe atë me vertetimin e evidencës ndëshkuese dhe penale në emër të akuzuarit A.ZH të dt... ku gjykata vërtetoi se i akuzuari është i dënuar për vepra të njëjta penale por që ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për veprë penale, gjykata konsideron se në veprimet e të akuzuarit A.Zh janë përmushur të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e rëndë të nenit 236 pr.1 pika 3 të KP, përderisa në veprimet e të akuzuarës J.B janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhje e rëndë të nenit 236 pr.1 pika 3 në lidhje me nenin 24 të KP. Për çfarë gjykata I ka shpallur fajtor dhe dënuar sikur në të shqiptuarën e aktgjyqimit, duke patur parasysh se e akuzuara J.B deri tani nuk është e dënuar dhe se lidhur me fajësin e saj nuk është prezentuar asnjë provë materiale, dhe se vet e akuzuara ka deklaruar se nuk është e dënuar dhe se nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

Gjatë caktimit të llojit dhe matjes së lartësisë së sanksionit penal, gjykata i kishte parasysh të gjitha rrethanat të neni 39 nga KP, dhe si rrethana rënduese ka konsideruar shkallën e përgjegjësisë penale, vëllimin e veprës penale, mënyrën tizante të kryerjes së veprës, rrethanat nën të cilën është kryer vepra penale, shpeshmërin e kryerjes së veprave të tilla, faktin se i autorizuar i të dëmtuarit D:B SHPK., ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, si dhe faktin se i akuzuari A.ZH., ka qenë i dënuar për vepra të njëjta penale, dhe se bëhet fjalë për përsëritës special, ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata ka marrë parasysh të ardhurat materiale personale, sidomos faktin se bëhet fjalë për persona të rinjë prej..., të papunësuar, pa pronësi. Sjellja e tyre e hijeshme në gjykatë dhe kontributi i tyre në përmbjlljen e procedurës si dhe vetëdijësimi i të akuzuarve gjatë shqyrtimit kryesorë lidhur me moslejimin e ndërmarrjes së veprimit, pendimin e sinqertë për veprën penale, faktin se e akuzuara J.B. nuk është e dënuar, dhe kundër saj nuk zhvillohet procedurë tjetër penale e që i ngarkohet vepra penale ndihma e dhënë në kryerjen e veprës penale e që sipas dispozitave të KP, mundet edhe më lehtë të dënohet, si dhe faktin se ndaj të akuzuarit A. nuk zhvillohet procedurë tjetër penale. Duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e theksuar duke patur parasysh se i akuzuari e pranojnë fajin, gjykata konsideron se më shqiptimin e sanksioneve penale dhe atë 1 vit burgim për të akuzuarin A.Zh, ku i është llogaritur dhe koha e kaluar në paraburgim si dhe masat alternative dënim me kusht për të akuzuarën J.B, në të cilën i

llogaritën edhe kohën e kaluar na paraburgim shtëpiak, mjaftushëm do të ndikoj ndaj të njëjtëve në të ardhmen të mos paraqiten si kryerës të veprëve penale, me çka do të arrihen qëllimet e dënimit të paraparë në ..32 nga KP, si në kuptim të prevencionit gjeneral, ashtu edhe në kuptim të prevencionit special.

Gjykata, në pajtim me nenin 114 të LPP, i obligon të akuzuarit bashkërisht të dëmtuarit D.B., DOO, Sh., ti kompenzojnë kërkesën pasuroro juridike në shumë prej 104,923,00 denarësh, shumë kjo që duhet të kompenzohet në afat prej 3 muajsh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë, gjithashtu për të akuzuara J.B vendoset në baza të nenit 49.pr.2 i KP, se nëse bashkërisht me të akuzuarin A.zh nuk e bëjnë kompenzimin pasuror jurisik i kërkuar nga i dëmtuari D.B SHPK .Sh., do të zbatohet dënimi me burg.

Përfaqësuesi i autorizuar i personi juridik D.B SHPK Sh., avokat E.D nga Sh., paraqiti kërkesë pronsore juridike prej 196.270,00 denarësh, në emër kompenzimit të dëmit në shumë prej 104.923,00 denarësh, gjykata i obligoi të akuzuarit që të kompenzojnë këtë shumë prej 104.923,00 denarësh ndërsa për shumë e paraqitur e udhëyon të dëmtuarin që ta largojnë kontest.

Duke patur parasysh që gjykata i shpalli fajtorë të akuzuarit A.Zh i J.B I ka obliguar në pajtim me nenin 102 dhe 105 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë penale të paguajn paushallin gjyqësor prej 2.00,00 denarësh, si dhe ti kompenzojnë harxhimet e caktuar në procedurën penale dhe atë i akuzuari A.Zh të paguaj shumë prej 3.233,00 denarësh në emër të harxhimeve për transport zyrtar nga burgu i shkupit Shkup , si dhe shumë prej 4.000,00 denarësh, në emër të dhuratës dhe dhuratave tjera me rëndësi për mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare, avokat G. K. nga SH., ndërsa e akuzuara J.B. Obligohet të paguaj shumën prej 960,00 denarësh në emër të shpenzimeve për transport të personave zyrtarë të paraqitur në Listën për shpenzimetë MPB , SP G.B, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi ka marrë formën e prerë, ndërsa nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP

P.nr.....t; dt.....,

Procesverbaliste Gjykatës

UDHËZIM: Kundër këti aktgjykimi lejohet ankesë në afat prej 8 ditë, pas pranimit të të njejtës, përmes kësaj gjykate deri te gjykata e Apelit Shkup.

2.3.1. Analiza e rastit të tretë nga praktika gjyqësore

Meqë në organet e drejtësisë është bërë sfida lufta kundër kryerësve të veprave penale kundër pasurisë, e veçanërisht kundër veprave penale të vjedhjes. Vjedhja konsiderohet si marrje e pasurisë së huaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj për vete apo për personin tjetër.

Gjykata në rastin konkret ka vendosur të dënoj të akuzuarit A.ZH dhe JB., për veprë penale Vjedhje të rëndë në pajtim me nenin 236 të KP, apo të akuzuarin A.ZH., për veprën penale të paraparë në nenin 236 paragrafi 1 pika 3 dhe të akuzuarën J.B., për veprën penale Vjedhje e rëndë në pajtim me nenin 236 paragrafi 1 pika 3 në lidhje me nenin 24 të Kodit Penal, me çrast të akuzuarit A.ZH., i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa të akuzuarës JB, i shqiptoi masë alternative dënim me kushtë me të cilën i përcaktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve dhe se e njëjta nuk do të ekzekutohet përderisa e akuzuara në afat prej 5 viteve nga dita kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë, nuk kryen veprë tjetër penale

Në të njëjtën kohë i ka obliguar të akuzuarit në pajtim me nenin 114 të Ligjit për procedure penale ti kompenzojnë të dëmtuarit D.B. SHPK SH., kërkesën pasurore juridike në shumën prej 104.923,00 denarë në afat prej 3 muajve pasi aktgjykimi ka marrë formë të prerë, sepse më dt.05.09.2018 rreth orës 13,00 në Sh., në rr. nr.në bastore sportive M. Filialja nr....., pronësi e D.B SHPK, me qëllimin e përvetësimit të kundërligjshëm, në mënyrë tinzare kanë marrë 104.923,00 denar, në mënyrë që një ditë më herët më 04.09.2018 janë marrë veshë dhe e akuzara J.B me vetëdije i ka ndihmuar me vetë dhënien e premtimit se do ti ndihmoj për të hyr dhe për të hapur kutin e sigurisë në filiale e cila hapet një herë në ditë e cila është me kod të cilën e ka ditur

ajo dhe me dhënjën e kodit duhet të pritët 10 minuta, më dt.05.09.2018, rrethë orës 12,30 e ka hapur kutin e sigurisë dhe ka marrë veprimin numrimin e parave, pas së cilës i akuzuari A.ZH ka hyrë me bejzboll i zi, kapel dhe gojë të mbyllur dhe ka drejtuar armën mark e panjohur drejt të akuzuarës J.B,e cila në atë moment ja ka dorzuar të hollat të cilat ishin në kutin e sigurimit.

Gjykata vlerësoi se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat ishin të mjaftueshme për të vërtetuar fajësin e të akuzuarve, se kishin kryer veper penale për të cilën akuzoheshin e sidomos pranimi i fajësisë. Objekti i veprës penale është e mira juridike në rastin konkret të hollat. Mirpo në rastin konkret kemi edhe bashkëkryerje të veprëspenale, kur dy të akuzuarit kryejnë veprë penale.

Në aktgjykimin e lartëpërmendur kemi rastin kur dëmi material është shkaktuar nga ana e personave fizik ndaj personit juridik, si dhe në këtë rast gjykata pjesërisht ka vendosur për kërkesën pasuror juridike të të dëmtuarit, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesës pasuror juridike e udhëzon të dëmtuarin ta realizoj në kontest civil. Nga kjo vëmë në përfundim se gjykata për kërkesën pasuror juridike vendos plotësisht , pjesërisht ose e udhëzon palën në kontest.

2.4. Rasti katër–Aktgjykimi i shpallur në vitin 2019

XX P.nr....

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË VERIORE

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP, si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjykatësit F.J.M. si gjykatës i vetëm, me procesverbalist O.A-punëtorë gjykate, duke vepruar sipas propozim akuzës së PTHP-SH., AP2 nr...., të dt....., me precizimin e dt.07.10.2019 kundër të akuzuarit N.A., nga f...,për vepër penale - Mashtrim nga neni 247 paragrafi1nga Kodi penal, pas mbajtjes së seancës kryesore, verbale dhe të hapur, në prezencë të Prokurorit publik të PTHP Shkup-A.M., dhe në mungesë të të akuzuarit N.A., i thirrurr në mënyr të rregullt, në bazë të nenit 479 paragrafi 2 nga Ligji për procedurë penale, më dt.07.10.2019 e solli dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI

N.A., me NUAQ....., nga babai....., nëna....., i lindur më....., në SH., sipas dokumentit për identifikim me adresë në rr....., nr...., ndërsa jeton në rr....., nr...., SH., shqiptar, shtetësia e Maqedonisë, i dënuar, ndaj tij zhvillohen procedura për vepra tjera penale.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Në peridhën prej dt.22.06.2016 deri më dt.23.08.2016, në afërsi të "M.M" më saktësishtë te pompa e benzinës " B", i akuzuari N.A. me qëllim që për vete të përfitoj në interesin e tij pasuri të kundërligjshme, me vetë tregimin e rremë të lejes për prerjen e drunjve për ngrohje, e ka mashtruar dhe e ka mbajtur në mashtrimtë dëmtuarin E.Z.se me kamion do ti porosisëdru për ngrohje, dhe kështu në dëm të pasurisë së tij i dëmtuari ka porositur që ti dërgohen 24m3 dru për

ngrohje në shumën prej 60.000,00 denarë, pre cilës shumë i dëmtuari në emër avans të akuzuarit i ka dhënë vlerën e 38.000,00 denarëve, dhe pas marrjes së avansit të kërkuar në shumën prej 38.000,00 denarëve i akuzuari, as nuk ia kishte dërguar drunjët të dëmtuarit dhe as nuk ia kishte kthyer të hollat në shumën prej 38.000,00 denarë, e gjatë komunikimeve të ndërsjellta ka gjetur justifikime se pse nuk ia kishte dërguar drutë, e që më vonë edhe i kishte ikur kontakteve telefonike.

Me veprimet e lartpërmendura i akuzuari N.A. Nga SH., ka kryerë veprën penale - Mashtrim të nenit 247 paragrafi 1 të Kodit penal, dhe në pajtim me nenet e theksuara dhe nenet 4,32,33,34,35, dhe 39 të Kodit penal, e:

DËNON

ME DËNIM ME BURGIM PREJ 2-dy viteve

Në pajtim me nenin 105 paragrafi 1 në lidhje me nenin 102 paragrafi 2 të ligjit të Procedurës penale, OBLIGOHET i akuzuari të paguaj shumën prej 5.000,00 denarësh, në emër të paushalit gjyqësor, në xhirollogarin nr 100000000063095, llogari të shfrytëzuesit buxhetorë 2901000973, njësia 631, shfrytëzues 10, shifra 724 132, programa 20, mënyra 2, pranues Gjykata themelore Shkupi 1 Shkup, deponent BPRM, të gjitha në afat prej 15 ditëve pasi aktgjykimi të marrë formë e prerë, nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 114 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë penale, **OBLIGOHET** i akuzuari N.A. të kompenzojë dëmin të dëmtuarit E.Z në shumën prej 38.000,00 denarë, në afat prej 8 ditëve, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë.

ARSYETIM

Më datë 20.11.2017 PTHP SH., deri te kjo gjykatë parashtroi propozim akuzën AP.2nr..., të dt.12.10.2017, kundër të akuzuarit N.A nga f..., për veprën penale-Mashtrim të nenit 247 paragrafi 1 të Kodit penal, me precizimin e bërë në fjalën përfundimtare në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të dt.07.10.2019.

Gjykata duke proceduar sipas propozim akuzës, të dt. 07.10.2019, mbajti shqyrtim kryesor, verbal dhe e hapurpa pranin e të akuzurit të thirrur në mënyrë të rregullt, në pajtim me nenin 479 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë penale sepse i akuzuari nuk ka ardhur në seancën e shqyrtimit kryesorë të dt.01.07.2019, edhe pse i akuzuari N.A. i është përgjigjur thirrjes gjyqësore dhe kërkoi shtyerjen e seancës sepse kishte angazhuar avokat mbrojtës, por mbrojtësi për shak se ishte zënë nuk ka mundur të vijë në seancën e caktuar. Gjykata kishte parasysh faktin se kjo procedurë zhvillohet sipas rregullave të procedurës së shkurt dhe për veprën penale për të cilën është parashikuar dënimi me burgim deri në tre vjet, dhe të holla, që nënkupton se janë përmbushur të gjitha kushtet e mbajtjes së shqyrtimit kryesorë pa pranin e të akuzuarit të thirrur në mënyrë të rregullt.

Prokurori publik në fjalën përfundimtare ka bërë precizimin e propozim akuzës sikur në të shqipturën e aktgjyqimit, dhe pasi qëndron në precizimin e bërë ka thënë se nga të gjitha provat e nxjerrura verbale dhe materiale padishym është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Mashtrim të nenit 247 paragrafi 1 të KP. i propozoi gjykatës të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe dënoj në bazë të ligjit.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë, gjatë administrimit të provave janë nxjerrur provat e propozuara nga Prokurori publik në pajtim me nenin 371 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë penale, pas marrjes në pyetje të palëve ishte lexuar dëshmia e të dëmtuarit E.Z. të thënë në procesverbalin jashtë shqyrtimit kryesorë të dt.03.12.2018, dhe në vazhdim të procedurës së administrimit të provave ishin nxjerr provat e shkruara edhe atë procesverbali për pranimin e kallximit penal nr....., të dt....., certifikatë nga krim evidenca Kp.nr....., të dt....., dhe duke i vlerësuar të gjitha provat çdonjëren në veçanti dhe të gjitha sëbashku në një tërësi të provave, ndërsa sipas bidnjës së lirë gjyqësore, ka vërtetuar gjendjen faktike si në vijim:

Në periudhën prej dt.22.06.2016 deri më dt.23.08.2016, në afërsi të "M.M" më saktësishtë te pompa e benzinës " B", i akuzuari N.A. me qëllim që për vete të përvetësoj pasuri të kundërligjshme, me vetë tregimin e rremë të lejes për prerjen e drunjëve për ngrohje, e ka mashtruar dhe e ka mbajtur në mashtrimtë të dëmtuarin E.Z.se me kamion do ti porosisëdru për

ngrohje, dhe kështu në dëm të pasurisë së tij i dëmtuari ka porositur që ti dërgohen 24m³ dru për ngrohje në shumën prej 60.000,00 denarë, pre cilës shumë i dëmtuari në emër avans të akuzuarit i ka dhënë vlerën e 38.000,00 denarëve, dhe pas marrjes së avansit të kërkuar në shumën prej 38.000,00 denarëve i akuzuari, as nuk ia kishte dërguar drutë të dëmtuarit dhe as nuk ia kishte kthyer të hollat në shumën prej 38.000,00 denarë, e gjatë komunikimeve të ndërsjellta ka gjetur justifikime se pse nuk ia kishte porositur drutë, e që më vonë edhe i kishte ikur kontakteve telefonike.

Gjendjen faktike të mëlartme gjykata e vërtetoi nga provat e nxjerra verbale dhe materiale gjatë proseancës së shqyrtimit kryesorë.

Provat se i akuzuari N.A gjatë kontakteve me të dëmturin E.Z. i kishte premtur se do ti porosis dru për ngrohje dhe se në mënyr të rreme i ka treguar se ka leje për prerjen e drunjëve, gjykata i vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit E.Z. i cili ka thënë se i akuzuarisi i punësuar në një firmë private ka punuar në pyll, ku ka bërë prerjen dhe shitjen e drunjëve. Ka bërë prerjen e drunjëve në rajonin e P., apo më konkretisht në malin që është zonë e L. M.të maleve të Osogovës. Në vendin ku i dëmtuari banonte kishin kuptuar se N.A. shiste drunjë dhe ishte koncesioneri që e kishte marrë pyllin. I dëmtuari së bashku me kolegun e tij e kishin takuar të akuzuarin N., në Z., e kishin pyetur për drunjë për cmimin,efar lloji të drunjëve ka, si dhe a mund të blenin drunj nga ai. I akuzuari ju ka thënë se ka dru, por se duheshte që më parë të japin kaparin. Ishin marrë veshë për një kamion dru që përafërsisht përfshinte 24m³, në shumën e 2.000,00 denarë për 1m³. I akuzuari i ka thënë se kur do ti siguroj drunjëtdo të ja qoj në shtëpi dhe pastaj do ti paguajn edhe pjesën tjetër të mbetur të shumës. I dëmtuari kishte pritur një periudhë, ndoshta kishte kaluar 1 muaj që kur i akuzuari ju kishte lajmëruar me telefon dhe i kish thënë se i duhën urgjent të holla për të paguar për gjoja marrjen e lejes për prerje, por edhe se punëtorve duheshte ti paguaj mëditje. Atëher i akuzuari i kishte thënë të dëmtuarit E.Z.se nëse vjen deri në SH., të sjell një pjesë nga të hollat. Fillimisht I kishte kërkuar të gjitha të hollat që me lirim ti sjellë të gjithë kamionin me drunj për ngrohjepër shumën e 60.000,00 denarë. I dëmtuari ju kishte përgjigjur se nuk ishte në gjendje të jepte shumën e plotë , por se mund të paguante një pjesë nga kapari. Pas një jave i dëmtuari E.Z. Duke ardhur për r në S..., e kishte thirru në telefon të akuzuarindhe ishin marrë vesh të takohen te pompa e benzinës "B", . Ishin

takuar në këtë vend , i akuzuari kishte nzjerrur arkën e pranimi, kurse i dëmtuari kishte dhënë shumën prej 38.000,00 denare. Që te dytë e kanë nënshkruar dokumentin dhe nje kopje kishte marr i dëmtuari. I akuzuari N.A. i kishte premtuar dëmtuarit se të njëjtën ditë deri në mbrëmje , kamioni me dru do të jetë në shtëpin e tij. Të dëmturit i kish dhënë numër telefoni të shoferit që do të voziste kamionin me drunjë. I dëmtuari kishte prituri deri ne mbrëmje dhe pasi që drunjët nuk i kishin ardhur e kishte thirrur në telefon shoferin e kamionit, i cili nuk ishte përgjigjur. I dëmtuar kishte thirrur në telefon, të akuzuarin N., i cili i kishte thënë se ka defekt në kamion dhe drunjët do ti arrijnë nesër. Ditën e nesërme përsëri nuk i kishin arritur drunjët, me çrast e kishte thirrur të akuzuarin N., i cili i kishte thënë se nuk mund tja sjell drunjt përshkak të problemeve teknike me kamion. Pas dis ditëve i dëmtuari kishte kuptuar se N., më nuk banon në Z..., me familjen , se ishin shpërngulur , dhe atje ku më herët kishte qëndruar N, tani kishte njëri të tjerë. I dëmtuari kishte shkuar deri atje dhe njerëzit e pranishëm i kishin thënë se N., nuk ishte koncesioner por vetëm punëtor si ato, dhe se koncesioneri ishte nga V..., i kishin thënë se edhe po të donte nuk do të mund ti sjellte drunjët i akuzuri sepse nuk ishte koncesioner dhe se ai kishte mashtruar edhe njerëz të tjerë. Ka sqaruar se kontakti i parë me të akuzuarin N. A., ishte bërë në Z..., sepse N., i kishte sqaruar të dëmtuarit E.Z., se drunjët ishin pronësi shtetërore e Manastirit L., dhe se personalisht ai -i akuzuari ishte marrë vesh dhe ishte i autorizur prej peshkopit, për ti prerë dhe shit drunjët. Sa i përket lejes për prerje i ish thënë se cdo gjë është rregulluar. I akuzuri me vete mbante fletushkën për dërgesa me arkën e pranimi. Ka thënë se i akuzuari nuk ia kishte kthyer paratë e dhëna avans dhe as nuk ia kishte porositur drunjt. Paralajmëroi dëmini në shumën prej 38.000,00 denar dhe filloi procedurën e ndjekjes. Ka thënë se pasi kishte parashtruar kallëzimin penal i akuzuari N. ju ka lajmëruar dhe i ka ofruar 100 euro si kushtë për ta tërhequr kallëzimin penal.

Provën se të akuzuari N.A. nuk i është dhënë leja për prerjen e drunjëve për vitin 2016, gjykata e vërtetoi prej shënimit të shkruar të NP. "PM"., nr...., të dt...., me shtojcën njoftimi I NP."PM"- Filiala K.

Provën se i akuzuari N.A, është përsëritës i shpësthtë profesional , del nga Vërtetimi P.nr...., të dt...., të Gjykatës themelore Shkupi 1 Shkup, në bazë së cilës duke filluar nga muaji korrik 2011 deri në nëntor 2016 i akuzuari N.A. ka pasur gjashtë dënime për vepra penale

Mashtrim të nenit 247 të Kodit penal, dy dënime për vepër penale Lajthimi të nenit 239 të Kodit penal, dhe një dënim për vepër penale lëndim trupor të nenit 130 të Kodit penal, si dhe ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera.

Duke e patur parasysh gjendjen e tillë faktike, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit përfshihen gjitha elementet kryesore të veprës penale-Mashtrim të nenit 247 paragrafi 1 i Kodit penal, sipas të cilit-" Kushëdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, sjell në lajthim dikë me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet ose vazhdon ta mbaj në lajthim dhe me këtë nxitë një person që të kryejë një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të huaj, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 viteve.

Në pajtim me nenin 39 të Kodit penal, gjykata ka caktuar lartësin e dënimit të të akuzuarit në kornizat e parapara për veprë penale nga neni 247 paragrafi i Kodit penal, është paraparë dënim në të holla ose dënim me burgim deri në tri vjet, duke patur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në lartësin e dënimit dhe kështu si rrethana rënduese gjykata vlerësoi kryerjen e shpeshtë të veprave penale , shkallën e përgjegjësisë penale rrezikun shoqëror, lartësin e shkaktimit të dëmit, faktin se i akuzuari është kryerës i shpeshtë i veprave penale ndaj të cilit zhvillohen procedura tjera dhe faktin se i dëmtuari kishte paraqitur kërkesën pronësore juridike, ndërsa si rrethana lehtësuese kishte parasysh moshën e të akuzuarit të lindur më dt...., dhe duke patur parasysh të gjitha rrethanat, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksion penal sikur në dispozitivin e aktgjykimit, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, gjegjësisht se do të arrihen qëllimet e preventivës gjenerale dhe speciale.

Në pajtim me nenin 102 dhe 105 të LPP, gjykata e obligoi të akuzuarin në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.000.00 denar në xhirollogarin nr 100000000063095, deponent BPRM, llogari të shfrytëzuesit buxhetorë 2901000973, njësia 631, shfrytëzues 10, shifra 724 132, programa 20, mënyra 2, pranues Gjykata themelore Shkupi 1 Shkup, të gjitha në afat prej 15 ditëve pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë , nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në pajtim me nenin 114 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për procedurë penale e obligoi të akuzuarin ti kompenzoj dëmin të dëmtuarit E.Z në shumën prej 38.000.00 denarë, në afat prej 8 ditë , pasi aktgjykimi të marë formën e prerë.

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1 SHKUP XX

P. nr..... të dt.....,

Procesverbaliste

O.A.

Gjykatësja

F.J.M

UDHËZIM: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankimi në afat prej 8 ditë përmes kësaj gjykate deri te Gjykata e Apelit Shkup.

2.4.1. Analiza e rastit të katërt nga praktika gjyqësore të shpallur në vitin 2019.

Në aktgjykimin e lartëpërmendur kemi rastin kur dëmi material është shkaktuar nga ana e personit fizik ndaj personit tjetër fizik. Njëkëtë rast dëmtuesi ka kryerë vepër penale Mashtrim nga neni 247 paragrafi 1 nga Kodi Penal.

Me çrast gjykata të akuzuarin e shpallë fajtor, sepse në peridhën prej dt.22.06.2016 deri më dt.23.08.2016, në afërsi të "M.M" më saktësishtë te pompa e benzinës " B", i akuzuari N.A. me qëllim që për vete të përfitoj në interesin e tij pasuri të kundërligjshme, me vetë tregimin e rremë të lejes për prerjen e drunjve për ngrohje, e ka mashtruar dhe e ka mbajtur në mashtrimtë dëmtuarin E.Z.se me kamion do ti porosisëdru për ngrohje, dhe kështu në dëm të pasurisë së tij i dëmtuari ka porositur që ti dërgohen 24m3 dru për ngrohje në shumën prej 60.000,00 denarë, pre cilës shumë i dëmtuari në emër avans të akuzuarit i ka dhënë vlerën e 38.000,00 denarëve, dhe pas marrjes së avansit të kërkuar ne shumën prej 38.000,00 denarëve i akuzuari, as nuk ia kishte dërguar drunjët të dëmtuarit dhe as nuk ia kishte kthyer të hollat në shumën prej 38.000,00 denarë, e gjatë komunikimeve të ndërsjellta ka gjetur justifikime se pse nuk ia kishte dërguar

drutë, e që më vonë edhe i kishte ikur kontakteve telefonike.

Mashtrimi si figure krimi dhe sanksionet ndaj tij i gjejmë të pasqyryara në Kodin penal. Nga vetë aktgjykimi mund të shohim se mashtrimi kërkon egzistencën e këtyre elementeve, veprimi i fajtorit që konsiston në gënjimimin e të dëmtuarit me anë të mjeshtërisë dhe dinakërisë dhe në fund kemi paraqitjen e një dëmi pasurorë dhe njëkohësisht një përfitim i padrejtë për personin që ka kryer veprimin e kundërligjshëm.

Mashtruesi nëpërmjet gënjeshtreve ose shpërdorimin e besimit arrin që viktima të dëmtohet vetë. Pra në rastin konkret, ai e prek direkt pasurin e të dëmtuarit-të hollat edhe atë duke fshehur rrethanat e vërteta.


Këtu dëmi nënkupton pakësimin e pasurisë. Në rastin konkret Gjykat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale konkrete, Mashtrim , e dënon me denim me burgim prej dy viteve , por në të njëjtën kohë vendos edhe për kërkesën pasuroro juridike të të dëmtuarit, me çrast e obligon të akuzuarin që dëmtuesit ti paguaj shumën prej 38.000,00 denarë, në pajtim me nenin 114 tëLigjit për procedure penale.

KAPITULLI I TRETË

HULUMTIMI EMPERIK

Për këtë punim kamë bërë këtë hulumtim përmes pyetjeve të parashtuara në anketë. Anketën e kam realiyuar në formë të shkruar, te 50 qytetarë të qytetit të shkupert, të moshës 25-50 vjeçare. Të anketuarit janë persona të punësuar dhe të papunësuar. Është realizur në nëntor të vitit 2019. Qëllimi I vetëm I anketës është marrja e informative më të sakta lidhur me informimin e qztetarëve sa I përket të drejtës së kompensimit material, dhe realizmin e tij.

PYETËSORI:




Grafikoni nr.1

Në lidhje me pyetjen e bërë se a e bëjnë anketauarit dallimin në mes të dëmit material dhe jomaterial, pjesa më e madhe e tyre apo 70% janë përgjigjur se e bëjnë dallimin e këtyre kompensimeve, ndërs të tjerët apo 20 % prej tyre janë deklaruar se nuk e bëjnë dallimin , dhe 10

% se pjesërishtë e bëjnë dallimin.


2. A keni njohuri se ku duhet të drejtoheni për të realizuar të drejtën tuaj për kompensimin e dëmit material?



Grafikoni nr. 2


Në këtë grafikon janë paraqitur të dhënat lidhur me atë se sa kan njohurir qytetarët dhe se ku duhet të drejtohen për realizimin e së drejtës së tyre për kompensim të dëmit material, ku vërejmë se 65% kanë njohuri , 30% janë deklaruar se pjesërisht kanë njohuri, dhe 15% janë deklaruar se nuk kan njohur.

3. Nga e keni kuptuar për të drejtën e kompensimit të dëmit material.




Grafikoni nr.3

Në këtë grafikon shohim se 50% e të anketuarve janë deklaruar se për të drejtat e kompenzimit të dëmit material kanë dëgjuar nga shoqëria gjë që na jep të kuptojmë se kemi njënumër të konsiderueshëm të qytetarëve të cilat kanë njohuri të përgjithshme, pastaj 20% e të anketuarve janë përgjigjur se e kanë lexuar në gazeta, kur dihet që gazetat janë edhe pjesë e përditshmëris sonë për ti lexuar, më ka treguar avokati, kam dëgjuar në gjykatë janë deklaruar 15% e të anketuarve.




Grafikoni nr.4

Të anketuarit janë përgjigjur se 80% e tyre nuk kanë qënë ndonjëherë palë e dëmtuar, që nuk u është dëmtuar prona, pasuria ose shëndeti, 15% janë deklaruar se vetëm njëherë kanë qënë palë e dëmtuar, dhe 5% prej tyre kanë deklaruar se disa herë kanë qënë palë e dëmtuar.



Grafikoni nr.5

Edhe pse qytetarët kompenzimit e dëmit kanë të drejtë ta realizoj në procedurë gjyqësore e dhë jogjyqësore me parashtrimin e kërkesës deri te personi që i ka shkaktuar dëm qoftë person fizik apo juridik, shohim se 68% , përqind e të anketuarve janë përgjigjur se kompenzimin e dëmit e kanë realizuar në procedur gjyqësore gjë që tregon se nuk kan mundur të arrijnë marëveshje për kompenzimin e dëmit konkret , në rastin konkret, pastaj, 30% e të anketuarve janë përgjigjur se kompenzimin e dëmit e kanë realizur në procedurë jokontestimore, dhe 2% janë deklaruar se fare nuk e kanë realizuar këtë kërkesë.



Grafikoni nr.6


Në këtë grafikun të paraqitur shohim se 50% e të anketuarve janë përgjigjur se dëmi i shkaktuar mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, 47 prej tyre janë deklaruar se nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, dhe 3 % janë deklaruar se vështirë mund të kthehet, edhe pse të shpeshta janë rastet kur dëmi material nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme.



Grafikoni nr.7

Në këtë grafikun shohim qartë se 85% e të anketuarve nuk kanë parashtruar kërkesë


pasuroro juridike, dhe se 15 % e tyre kanë parashtruar kërkesë gjë që na le të kuptojmë se qytetarët në rastin konkret ose nuk kanë qenë pjesë e ndonjë procedure penale, ose nuk kanë njohuri lidhur me atë se qfarë është kërkesa pasuroro juridike.



Grafikoni nr.8

Nga grafikoni i paraqitur shohim se si qytetarët nuk kanë njohuri për të drejtat lidhur me kërkesën pasuroro juridike për kompensimin e dëmit material, ku shohim qartë se qytetarët shumë pak kanë njohuri lidhur me të drejtën e kompensimit të dëmit material në gjykatën penale Shkup prandaj 15 % e tyre janë deklaruar se bëhet në këtë gjykatë, qytetarët 50% janë deklaruar se kërkesa e tillë parashtrohet në Gjykatën civile Shkup, 30% në kompani sigurimi dhe 5% se nuk janë të sigurt.


9. E drejta e jonë e rregullon edhe në procedurë penale cështjen e kompenzimit material , krahas veprës penale, cfar mendoni a është në rregull kjo?



Grafikoni nr.9

Nga grafikoni më lart shohim se 50% e të anketuarve zgjedhjen e cështjen e kompenzimit material në gjykatën penale e shohin si të pa bazë, 30% mendojnë se është mënyra më e mirë dhe 20 nuk kanë mendim lidhur me këtë cështje.

10. A mendoni që gjykatat janë institucioni adekuat për realizimin e të drejtës suaj lidhur me kompenzimin e dëmit material



Grafikoni nr.10

Të dhënat nga kjo tabelë na japin të kuptojmë se të anketuarit në rastin konkret qytetarët e qytetit të Shkupit, nuk kanë njohuri për funksionimin e gjykatave, prandaj edhe 60% janë

deklaruar se nuk e di, vetëm 20% prej tyre janë deklaruar se kanë njohuri dhe se mendojnë se janë institucione adekuate, si dhe 20 % e tyre janë deklaruar se nuk janë institucioni adekuat për realizimin e kësaj të drejte.

PËRFUNDIMI

Dëmi mund të shkaktohet me veprimin apo mos veprimin e njeriut, shtetit, oragnizatave, personave juridik, kafshëve, por me vetë shkaktimin e dëmit, paraqitet detyrimi për kompenzimin e tij. Dëmi matërial paraqitet si zvoglim i pasurisë së dikujtë dhe si ndalim i zmadhimit të sajë(si fitim i humbur).

Pa marrë parasyshë llojet e dëmeve, nuk mund të themi që çdo herë është e mundur kompenzimi i plotë i dëmit, por në një farë mënyre bëhet kompenzimi si lloj satisfakcioni, sepse në këtë mënyrë të paktën palëve u ofrohet pjesërisht satisfakcioni për shkak të dëmit të pësuar.

Në Republikën e Maqedonisë Veriore, e drejta e kompenzimit të dëmit material është e rregulluar me Ligjin për mardhëniet detyrimore. Miëpo e drejta e kompenzimit të dëmit material në të drejtën tonë parasheh edhe mundësin e kompenzimit të dëmit material në përputhshëri me procedurën penale me vetë parashtrimin e kërkesës pasuroro juridike për kompenzimin e dëmit. E cila kërkesë mund të paraqitet nga personi i dëmtuar qoftë person fizik apo juridik. I paraqitet organit kompetent, prokurorit apo gjykatësit gjatë procedurës penale. Edhe pse në praktikën gjyqësore ekziston pasivitet në realizimin e kësaj kërkesë pasuror juridike sidomos me rastin e pranimin të fajësisë dhe në rastet e shqyrtimit të mundësis për propozim marrëveshje. Rradhë herë ndodhë që kërkesa pasuroro juridike të caktohet sidomos në rastet kur kemi propozim marrëveshje për pranimin e fajësisë, dhe në vend që gjykata të vendos për kërkesën pasuroro juridike e udhëzon palën ta realizoj në kontest.

Kompenzimi i dëmit material zakonishtë në praktik kërkohet edhe në procedurë penale dhe civile. Në procedurë civile kërkohet në formën e kompenzimit të dëmit material për shkak të harxhimeve për mjekim si pasojë e lëndimeve trupore që i dëmtuari i ka marrë gjatë ndonjë aksidenti të shkaktuar në komunikacion rrugor, ose në rastet e vdekjes së ndonjë personi, ktu hin harxhimet e bëra me rastin e varrosjes së të dëmtuarit, apo kur kërkohet kompenzimi i dëmit për shkak të veturës që i është dëmtuar, me çrast i dëmtuari kërkon kompenzim të dëmit material. Kjo është rregulluar në Ligji mbi mardhëniet e detyrimeve i Republikës së Maqedonisë në nenin 147 parasheh që ai që me fajë do ti shkaktoj dëm tjetrit është i obligueshëm që ta kompenzojë dëmin e shkaktuar. Nga kjo konkludojm se për të ekzistuar dëmi matërial apo jomaterial përpos subjekteve që bënë kryerjen e veprës duhet të ekzistoj edhe faji.

Kompenzimi i dëmit material në ratet kur gjykata krahas çështjes penale ka vendos edhe

për kërkesën pasuror juridike të të dëmtuarit, më të shpeshta i hasim te veprat penale kundër pasurisë edhe te veprat penale të vjedhjes, mashtrimit, lajthimit, pastaj te dhuna , dhunimet etj. Prandaj edhe në organet e drejtësisë është bërë lufta kundër kryerësve të veprave penale e veçanërisht të këtyre veprave të cekura më lartë.

Legjislacioni ynë penal ka rregulluar të drejtën e kompenzimit të dëmit material përmes parashtrimit të kërkesës pasuror juridike, ku edhe në vetë Ligjin për procedurë penale është paraparë dhe rregulluar me nenin 114 të këtij ligji sepse edhe nga vet analiza paraprake e aktgjykimeve nga praktika gjyqësore pamë se gjykata kryesisht vendos në pajtim me nenin 114 të këtij ligji për kërkesën pasuror juridike të palës së dëmtuar. Kështu pra veprimtaria gjyqësore lidhur me kërkesën pasuror juridike të të dëmtuarit zhvillohet në kuadër të procedurës penale, në procedurën e ashtuquajtur procedurë ad-hezione-procedurë e bashkangjitur e cila i bashkangjitet procedurës penale. Edhe pse një kohë të gjatë ka pasur mendime se procedura e kombinuar penale karakterizohet me ngadalësi dhe joefikasitet.

Edhe pse legjislacioni ynë e ka të përcaktuar dhe rregulluar kompenzimin e dëmit material, megjithatë nuk kemi njohuri lidhur me këtë çështje apo këtë temë, sepse shpeshherë palët e dëmtuara nuk kanë njohuri për kërkesën pasuror juridike të cilën mund ta pasrashtrojnë në gjykatë, pra kemi nevojë që kjo temë më shumë të zgjerohet me qëllim që qytetarët më shumë të informohen.

Rekomandime

Gjykata duhet më shumë ti jep prioritet të drejtave të të dëmtuarit, të dëmtuarit të thirren për tu deklaruar në rastet e marrveshjeve të arritura për pranim të fajësisë për kërkesën pasuror juridike, sepse në këtë mënyr jepet garancion se gjykata plotësisht i respektojnë të drejtat e të dëmtuarit. Sepse në praktik ka raste të shumta kur gjykata shpall aktgjykim për shkak të pranimit të fajësisë mirëpo në arsyetimin e aktgjykimit e thekson se meqë pala nuk është deklaruar për kërkesën pronësor juridike gjykata ka vendosur të akuzuarin ta dënoj ose ti caktoj dënim me kusht.

Gjykata duhet palën ta njoftoj për të drejtat e saj alidhur me kërkesën pasuror juridike dhe mënyrën e realizimit të saj.

Gjykata të vendosë për kërkesën pasuror juridike në procedure penale , sepse kjo është

mënyra më e lehtë dhe e shpejtë për zgjedhjen e kërkesës pasuror juridike, e jo shumica e palëve të dëmtuara të udhëzohen që të drejtën e realitetit të kësaj kërkeje ta realizojnë në kontest civil, sepse nuk i dihet se sa i dëmtuari mund të qaset zgjedhjes së kërkesës pasuror juridike në kontest civil, ku nuk mund të jetë i sigurt se do të arrijë sukses.

Në fund themi drejtësia është e mirë përderisa u konvenon njerëzve. Ajo në të njëjtën kohë bëhet padrejtësi poqëse adresohet kundër tyre...Padrejtësia më e madhe është kur drejtësia shtrembërohet.

BIBLIOGRAFIA

1. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001
2. Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017
3. Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.124.
4. Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009, fq.17.
5. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.147 .
6. Kurtesh Saliu, E drejta Kushtetuese, libri I, Prishtinë, 2001, fq.252.
7. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq.55.
8. Dimitar Pop Georgiev, Obligaciono pravo, Zavod za unapreduvane na stopanstvoto vo SRM, Skopje, 1976
9. Galgono, F., E Drejta private, Tiranë, 2003, fq.285.
10. Gale Galev, Jadranka Daboviq Anastasovska, Obligaciono pravo, Shkup 2012
11. Jakov Radisis, Obligaciono pravo, opst del, Beograd, 2004
12. Milosheviq L., Obligaciono pravo , Univerzitet Novi Sad, 1966
13. Cavdar K. Praven Leksikon na trgovsko i gragansko pravo, Akademik, Skopje, 2004
14. Galev G., Jadranka D., Obligaciono pravo, Beograd, 2004
15. Dukoski Sasa, Obligaciono pravo, Kicevo, 2016.
16. Udhezues-per here te pare ne gjykate dhe per here te par ne gjykim, YUCOM, komitet pravniku za ljudska prava, Beograd

Ligje dhe burime të tjera

1. Kodit penal të Republikës së Maqedonisë.
2. Ligjin për mardhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë , Gazeta Zyrtare e R.M. nr.18, viti 2001, neni 145.
3. Ligjit për procedur civile të RM, Skopje, 2006.
4. Ligjin për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150, e dt.18.11.2010.
5. Doracak, për Ligjin për procedure penale, janar, 2012, Shkup.

Aktgjykime:

1. P.nr.,2118/16- rasti i pare nga praktika gjyqësore
2. P.nr. 1614/18 – rasti i dytë nga praktika gjyqësore
3. P.nr. 1704/16 – rasti i tretë nga praktika gjyqësore
4. P.nr. 1738/17-rasti i katër nga praktika gjyqësore
5. P.nr.2423/09 të Gjykatës Shkupi 1 Shkup
6. P.nr. 1165/13 të Gjykatës Shkupi 1 Shkup
7. P.nr.47/11 të Gjykatës Shkupi 1 Shkup

Burimet nga internet:

1. <https://studioligjore.ëordpress.com>
2. www.njohligjin.al
3. www.sud.mk

ANEX: PYETËSORI

LIRJETA RAMIZI:

Kompenzimi i dëmit material në Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht në gjykatën shkupi 1 shkup prej viti 2015 e këndej.

PYETËSORI:

Ju faleminderit për pjesmarrjen tuaj në plotësimin e këtij pyetësori. Emri im është Lirijeta Ramizi. Ky pyetësor është bërë për një hulumtim timin që jamë duke e ndërmarr lidhur me kompenzimin e dëmit material në Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht në gjykatën Shkupi 1 Shkup, si pjesë e punimit të diplomës në studimet postdiplomike në Universitetin e Evropës Juglindore .

Pyetësori përbëhet nga dhjetë pyetje. Pjesmarrja në këtë hulumtim është vullnetare, i gjithë informacioni do të bëhet anonim, dhe të gjitha të dhënat do të trajtohen si konfidenciale.

Pozita juaj aktuale në instuticionin tuaj?

Mosha?

1. A e bëni dallimin në mes të kompenzimit material dhe jomaterial?

- Po, e bëj dallimin
- Jo nuk e bëj dallimin
- Pjesërisht, e bëj dallimin

2. A keni njohuri se ku duhet të drejtoheni për të realizuar të drejtën tuaj për kompenzimin e dëmit materia?

- Po, sigurisht kamë njohuri

- Po, pjesërishtë kam njohuri
- Jo, nuk kamë njohuri

3. Nga e keni kuptuar për të drejtën e kompenyimit të dëmit material?

- E kam lexuar në gazet
- Më ka treguar avokati
- Kamë dëgjuar nga shoqëria
- E kamë kuptuar në gjykatë, në procedurë penale

4. A keni qenë ndonjëherë si palë e dëmtuar?

- Po, një herë
- Po, kam qenë disa herë,
- Asnjëherë nuk kam qenë

5. Të drejtën e kompenzimit të dëmit e kam realizuar në?

- Procedurë gjygjësore
- Procedurë jashtë gjygjësore
- Nuk e kam realizuar

6. A mendoni se dëmi i shkaktuar mund të kthehet në gjendjen e mëparshme?

- Po, mundet
- Jo, nuk mundet
- Vështirë se mundet

7. A ka ndodhur që të keni parashtruar kërkesën pasuroro juridike për kompenzim të dëmit material?

- Po
- Jo

8. Ku mendoni se duhet të parashtrohet kërkesa pasuroro juridike për kompenzim të dëmit material në ato raste kur me veprën penale u është shkaktuar dëm?

- Në gjykatën penale Shkupi 1 Shkup
- Në gjykatën civile Shkup
- Në kompani të sigurimit
- Nuk jam i sigurtë

9. E drejta jonë e rregullon edhe në procedurë penale çështjen e kompenzimit material, krahas veprës penale, çfarë mendoni a është në rregull kjo?

- Mendoj që mënyra e tillë është më e mirë
- Mendoj që mënyra e tillë është e pabazë
- Skam mendim

10. A mendoni që gjykatat janë institucioni adekuat për realizimin e së drejtës tuaj lidhur me kompenzimin e dëmit material?

- Nuk e di
- Po, mendoj se janë
- Jo, mendoj se nuk janë.